# Ali Bajram Hasku

U lind me 1923 ne Rahovec,mesimet fillestare kreu ne gjuhen serbokroate ne Rahovec.Ne kohen e Luftes kreu Gjimnazin-Normalen "Sami Frasheri" ne Prishtine. Pas dy viteve iu dha mundesia e burses nga Ministria e Arsimit te Shqiperise,ku pas nje viti iu nderpre per shkak te shperthimit te Luftes se dyte Botrore.Ne vitin 1946 si nxenes "problematik politik"nuk mundi t'a vazhdoj shkollimin ne Prishtine,ku i kreu dy vite ne kursin Pedagogjik ne Prizren.
Punen si mesues e filloi ne vitin 1947-48 ne Drenoc te Rahovecit ku burgoset ne aktakuz sepse nxensve iu ka vizatuar harten Etnike te Shqiperise, dhe burgoset me tre muaj.Pasi qe lirohet pas nje pause te shkurt punsohet si mesimdhenes ne gjimnazin e Istogut.Ne vitin 1951 ne munges te kuadrove kthehet ne Rahovec ku pas shume perpjekjeve dhe angazhimeve hapin internatin e pare ne gjuhen Shqipe ku punon si Drejtor internati,si qdo her edhe ketu punon vetem nje vite dhe e largojn na puna.
Pas nje kohe te shkurt punsohet ne Istog si profesor i gjuhes Shqipe,Histori dhe Edukat fizike.Si i papershtatshem politikisht e largojn edhe nga kjo pune.Pas largimit edhe nga kjo pune ,regjistron Fakultetin Filozofik ne Beograd.
Si absolvent ne vitin 1954 gjithhere ne kontakt me vendlindje informohet per mungesen e mesimdhenesve ne Gjimnazin e Gjilanit kthehet dhe ligjeron nje gjysmevjetor,pasi kthehet per ti perfunduar dy provimet e mbetura para Diplomimit,ku gjate gjithe kohes si nxenes,student,ligjerues ishte ne shenjester te pushtetit aktual ,burgoset ne aktakuz per ngritjen e Flamurit dhe kendimin e himnit Kombtar dhe dergohet ne burgun hetues ne Prizren ku qendron 18 muaj.
Gjykata e denon me 8 vite burgim dhe dy vite bur shtepiak,pas hetuesis transferohet ne burgun famkeq (Bella Kuqa) Nish.
Prej 1956-57 qendron plot dy vite i izoluar ne Qeli.Pas lirimit nga burgu punsohet si mesues ne Haxhe te Rugoves(Komuna e Pejes),ku po ne kete vite punon edhe ne shkollen Bujqesore te Pejes.Ne vitin 1961 punsohet si mesimdhenes ne Shkollen e mesme Ekonomike ne Ferizaj ku qendron tri vite.
Per shkak te mungeses se shkollave shqipe ne viset tjera Shqiptare shkon ne Delimegje(Komuna e Tutinit) ku nis punen si mesues ne shkollen Fillore me synim ta hap shkollen e Pare Shqipe,por pasi qe u zbuluan qellimet dhe mundesia qe prap te burgoset ishte shume afer dhe misioni i tij te mbetet i pakryer,detyrohet te kthehet ne Kosove ku hapsira e veprimit te tij ishte pak sa ma e lire.
Pas nje kohe te shkurt punsohet ne shkollen e mesme private per Agronomi ne Obiliq.
Ne vitin 1966 kthehet ne Peje ku punon si Profesor,Drejtor, ne shkollat e mesme:Gjimnazi,Teknike,Ekonomike etj
Ne vitin 1980 ne Shtator(fillimi i vitit shkollor) supsendohet nga puna,duke iu ndalu qe te hyj ne Oboret e Shkolles.Nxensit demostruan duke bojkotu mesimin,por pa sukses.Burgoset me tre muaj(pa drejt pensioni)
Ne vitin 1994 nga Presidenti i Shqiperis mer urdhrin "Naim Frasheri" te Klasit te Pare per kontributin e punes"Sherbeu ne Shkollat Shqipe ne Shqiperin e Veriore dhe Lindore jashte kufijve politik te viti 1913.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

PRESIDENTI I REPUBLIKES

I JEP

ZOTIT ALI BAJRAMI

URDHËRIN "NAIM FRASHËRI", TË KLASIT I

Tiranë më, 11.4.1994
Dekret Nr: 811

PRESIDENTI

SALI BERISHA

"SHËRBEU NË SHKOLLAT SHQIPE NË SHQIPËRINË VERIORE E LINDORE JASHTË KUFIJVE POLITIKË, TË VITIT 1913, TË SHTETIT SHQIPTAR".

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-543/1 VI
Data Datum Date 06.08.2020

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | **Smajl Latifi,** Kryetar i Komunës së Rahovecit<br>**Afrim Dina,** Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Goran Rakić** , Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme në MAPL | |
| Nga: | **Venera Çerkini,** Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MPL | Datë: 30/07/2020 VI-020-4543 |
| Zyrtarët përgjegjës<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së Rahovecit | |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi 01-Nr.90/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë |
| I miratuar më datë: 29.07.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.07.2020 |

vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim. |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi 01-Nr.90/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të datës 29.07.2020. | Vendimi 01-Nr.90/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë i miratuar ne Kuvendin e Komunës së Rahovecit të datës 29.07.2020, i cili ka për qellim ndërtimin e një objekti për pritjen dhe përcjelljen e mysafirëve në mënyrë tradicionale dhe kulturore me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në fshat, është në kundërshtim me nenin 5 pika 1.3 te Ligjit Nr.06/L-092 , për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pasi që ky ligj nuk parasheh dhënien e pronës së komunës për raste të tilla. Ligji Nr.06/L-092 , për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ka për qellim rritjen e vlerës së pronës së palujtshme të komunës si dhe zhvillimin e qendrushëm ekonomik.<br><br>Andaj bazuar në të lartë cekurat Kuvendi i Komunës së Rahovecit duhet ta rishqyrtoj këtë vendim dhe të veprojë në harmoni më legjislacionin në fuqi. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020-543/1
Data / Datum / Date 06.08.2020

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada – Government**
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo lokalne Uprave*
*Ministry of Local Government*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Smalj Latifi, gradonačelnik opštine Orahovac<br>Afrim Dina, predsedavjući Skupštine opštine Orahovac | |
| Kopija: | Jedinica za administraciju dokumenata u MLS<br>Jedinica za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MLS-u | |
| Od: | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLS | Dana, 30.07.2020. Vi-020-4543 |
| Odgovorni službenici:<br>1. Službenik za utvrđivanje pravne procene :<br>2. Službenik-ca za izradu pravne procene: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština,<br>Ardita Latifi, službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Orahovac | |
| Vrsta akta: | ☐ Odluka skupštine opštine | |

Uvažani gradonačelniče,
Uvaženi predsedavjući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih ovalćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o administrativnim oblastima i odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01-Nr.90/20 o davanju na dugoročno korišćenje opštinske imovine |
| Usvojena dana, 29.07.2020.godine. |
| Dostavljena na razmatranje u MLS-u dana, 30.0.2020. godine. |

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine ocenjuje da je opštinski akt u **suprotnosti sa sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

Neusaglašenosti opštinskog akta koji je podnesen za ocenjivanje zakonitosti su kao u nastavku:

| **Br.** | **Formulisanju u aktu opštine** | **Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti.** |
|---|---|---|
| 1. | Odluka 01-Nr.90/20 o davanju na dugoročno korišćenje opštinske imovine | Odluka 01-Nr.90/20 o davanju na dugoročno korišćenje opštinske imovine usvojena u Skupštini opštine Orahovac od dana, 29.07.2020. godine, čija je svrha izgradnja jednog objekta za doček i ispračaj gostiju na tradiocionalan i kulturan način povodom odvijanja raznih aktivnosti u selu, u suprotnosti je sa članom 5 tačkom 1.3 Zakona br.06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, pošto ovaj zakon ne predviđa davanje opštinske imovine za takve slučejeve. Cilj Zakona br.06/L-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine je povećanje vrednosti nepokretne imovine opštine kao i održivi ekonomski razvoj.<br><br>Stoga, na osnovu gore pomenutih, Skupština opštine Orahovac, treba da revidira ovaj akt i da deluje u skladu sa zakonodavstvom na snazi. |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samuprave zahteva od Skupštine opštine / gradonačelnika opštine da preduzmu konkretne mere za usklađivanje opštinskog akta sa važećim zakonskim odredbama, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta

Ministarstvo lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za svako objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec*

Nr/Br/No 01/130 Nr i faq/Br str/No pg 2
Data/Datum/Date 29/07/2020

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/2019), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 40, 46, 57 dhe nenit 94 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.07.2020 merr këtë:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 30.07.2020
-01- 020-553

# VENDIM
## Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/975/20 i datës 10.07.2020 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Çiflak në vendin e quajtur Groble - Qerana, me kulturë kullosë e klasës 2, e evidentuar sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00169-1 në emër të P.SH. E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 3541m$^2$ (tre mijë e pesëqind e dyzet e një metra katror) dhe në shfrytëzim jepet pjesa në sipërfaqe prej 250m$^2$ (dyqind e pesëdhjetë metra katror).

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është interes i përgjithshëm si dhe ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, në të cilën planifikohet të ndërtohet një objekt për komunitetin, i cili ka për qëllim pritjen dhe përcjelljen e mysafirëve në mënyrë tradicionale dhe kulturore me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në fshat.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

5. Prona e cekur në pikën 2 të këtij propozimi jepet në shfrytëzim pa kompensim në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

6. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdoherë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të këtij vendimi të përcaktoj me kontrate të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

9. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

*Vendimi u dërgohet:*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 90/20
Me datë: 29.07.2020

Afrim Dina
Kryesuesi i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opštinska Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC/ORAHOVAC

Nr.Br.No 90/01 Nr.i faq/Broj str/No.pg 2
Data/Datum/Date 29/07/2020

Na osnovu člana 12. stav 2. slova (d), člana 17. i člana 40. Zakona za Lokalnu Samoupravu Kosova br. 03 / L-040 ("Službeni list Republike Kosovo", br. 28/2008), član 5 , član 6. stav 1. tačka 1.2. i član 8. stav 1. tačka 1.2 Zakona br. 06 / L-092 o dodeli na korišćenje i zameni opštinske nepokretne imovine („Službeni list Republike Kosovo", br. 10/2019), član 10 stav 2 tačka 2.4, 40, 46, 57 i član 94 stav 1, 2 i 3 Statuta opštine Orahovac br. 1005 od 29.03.2017. godine, Skupština opštine Orahovac na održanoj sednici 29.07.2020, donosi:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 30.07.2020
-01- 020-593

## ODLUKU
**Za dodelu na dugoročno korišćenje**

1. Usvaja se predlog Predsednika br. 02/975/20 od 10.07.2020. godine i donosi se prethodna odluka o dodeli na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine fizičkim i pravnim licima u roku od 15 (petnaest) do 99 (devedeset devet) godina.

2. Nepokretna imovina koja se dodeljuje na korišćenje navedena u tački 1. ove odluke, nalazi se u katastarskoj zoni Čiflak, na mestu zvanom Groblje - Ćerana, sa kulturom pašnjaka 2. Klase, identifikovana prema potvrdi vlasništva br. P-71510081-00169-1 u ime D.I. S. Kosova, S.O Orahovac, ukupne površine 3541m2 (tri hiljade petsto četrdeset i jedan kvadratni metar), i na korišćenje daje se deo površine 250m2 (dvesta pedeset kvadratnih metara).

3. Cilj dodele na korišćenje opštinske nepokretne imovine navedene u tačkama 1 i 2 ove odluke je od opšteg interesa, kao i očuvanje i povećanje vrednosti opštinske javne imovine u kojoj je planirana izgradnja objekta za zajednicu, koji ima za cilj prijem i ispraćaj gostiju na tradicionalan i kulturan način tokom odvijanja raznih aktivnosti u selu.

4. Rok za prenos opštinske nepokretne imovine, pomenut u tačkama 1 i 2 ove odluke, je dugoročan u periodu od 99 (devedeset devet) godina.

5. Imovina navedena u tački 2 ovog predloga daje se na korišćenje bez nadoknade u periodu od 99 (devedeset devet) godina.

6. Opština Orahovac nosi pravo da izmeni ugovor sa korisnikom imovine date na korišćenje, kad god je to neophodno, radi ostvarivanja javnih interesa opštine.

7. Navedena nepokretna imovina ne menja pravnog vlasnika, njen vlasnik ostaje Skupština opštine Orahovac i kao takva se ne može dati trećem licu na korišćenje od strane korisnika, ne može se otuđiti, ne može biti izložena bilo kakvom poreznom teretu ili bilo kakvom drugom teretu ove imovine.

8. Obavezuje se predsednik da nakon usvajanja ove odluke posebnim ugovorom utvrdi prava i obaveze Opštine i korisnika imovine date na korišćenje.

9. Nakon usvajanja od Skupštine Opštine Orahovac, ova odluka stupa na snagu 15. dana nakon dostave pri nadzornim organu M.A.L.S, i 7 dana nakon javne objave na tabli objava ili internet stranici Opštine Orahovac.

*Odluku dostaviti:*

- *MALS, i*
- *Arhivi.*

SKUPŠTINA OPŠTINE ORAHOVAC

01 Br. 90.2020
Dana: 29.07.2020

Afrim Dina

Predsedavajući Skupštine

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Nr. 1987 Dt. 23.06.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

Kryrarit të Komunes së Rahovecit

Z.Smajl Latifi

Kërkesë

**Për ndërtimin të Shtëpis së Komunitetit (ODA E FSHATIT)**

Këshilli i fshatit Çifllak Kërkojmë nga Z.Smajl Latifi Kreytari I Komunes së Rahovecit që të na jep shfrytëzim një pjesë të parceles nr 169 për ndërtimin e Shtepis për Komunitetin (ODA E FSHATIT). Ku mundë të i kryejmë të gjitha ceremonit ,rastet e vdekjes ,dasmave si dhe ahengjeve të ndryshme familjare.

Fshati Çifllak numeron mbi 300 shtepi ose mbi 2000 banor andaj ne mendojmë se ndertimi një objekti të tillë është i domosdoshem.

Banoret e fshatit janë dakorduar se parcela e lartëshenua i plotëson të kushtet per këtë qellim sepse është afer Xhamis së fashtit dhe se nuk ashtë penges per ushtrimin e aktiviteteve të tjera të jetes normale në këtë fshatë

Ne mendojmë se siperfaqja prej 250 metra katror është e mjaftushme për ndertimin e këti objekti.

Duke shpresuar se kërkeses sonë do ti përgjigjeni pozitivishtë ju pershendesim përzemersishtë

Me respektë kshilli i fështit Çifllak

Çifllak

23/06/2020

Kryrati fshatit

Salij Thaqi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510081-00169-1

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0025606/20 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 06.07.2020 - 14:29 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | ÇIFLLAK / ĆIFLAK / ÇIFLLAK |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Povrtina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510081-00169-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | | Rural | 3541 | 6/2007 | | |

250 m²

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivalište - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| GROBLE-QERANA/GROBLE-QERANA/GROBLE-QERANA | | GROBLE-QERANA | | |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Povrlina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 3541 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažuriran<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual<br>Individualna Drzavina<br>Single possessor | P.SH.E<br>KOSOV.K.K.RAHOVEC | KCID1502206 | RAHOVEC<br>ORAHOVAC<br>RAHOVEC | | RAHOVEC 1/2 | 1/1 | 6/2007 | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çiflak

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510081-00169-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3541 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:699

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.07.2020

Koha/ Vreme/ Time: 02:42:06

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature

Lista e nënshkrimeve te Banoreve të Fshatit Çifliak për kërkes Komunes së Rahovecit

Për Shtëpi e Komunitetit [ODA E FSHATIT]

| Nr | Emri Mbiemri | Nr.persosnal | nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Sali Thaqi | 1008121857 | |
| 2 | [illegible] | 1008120702 | |
| 3 | Baki Saliuq | | |
| 3 | [illegible] Saliuq | 1008185910 | |
| 4 | [illegible] | 1008121106 | |
| 5 | [illegible] | 1008124064 | |
| 6 | [illegible] | 1008120273 | |
| 7 | [illegible] | 1008122381 | |
| 8 | AHMET KARASHI | 1008122373 | |
| 9 | [illegible] THAQI | 1008188951 | |
| 10 | [illegible] KRASNIQI | 100812153[illegible] | |
| 11 | [illegible] | 100818946[illegible] | |
| 12 | IBRAHIM THAQI | 1008185008 | |
| 13 | [illegible] KRASNIQI | 1008187433 | |
| 14 | [illegible] THAQI | 100818[illegible]358 | |
| 15 | MUHAMET KARASHI | 1008123981 | |
| 16 | HAJDAR KRASNIQI | 1008189206 | |
| 17 | [illegible] | 200812480[illegible] | |
| 18 | [illegible] | 1008186224 | |
| 19 | [illegible] THAQI | 100812300[illegible] | |
| 20 | [illegible] | 100818566[illegible] | |
| 21 | [illegible] KASTRATI | 1008184088 | |
| 22 | HAJDAR THAQI | 1008189915 | |

Çifliak

23-06-2020

Kryetari I Këshillit të Fshatit

Sali Thaqi

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.07.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z.Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kolegë kuvendarë, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

## REND DITE

1. **Aprovimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,**
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale P- 04381-0,**
7. **Shqyrtimi i dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër,**
8. **Shqyrtimi i Raportit të DKA-së rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020,**
9. **Shqyrtimi i Informatës nga DSHPS-ja për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020,**
10. **Shqyrtimi i Informatës mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit,**
11. **Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**

**Kryesuesi-** Te nderuar kuvendarë, a ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës.
**Fehmi Hoxha** – Përshëndetje Kryesues, nënkryetar, kuvendarë, drejtorë të ekzekutivit, media dhe gjithë ju të pranishëm. Unë nuk kam ndonjë pikë shtesë për të shtuar mirëpo e shoh që është ndonjë gabim apo lëshim teknik tek pika e tretë: Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të punës së Kryetarit të Komunës se Rahovecit për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020. Unë mendoj se nuk aprovohet raporti i kryetarit të komunës, që me siguri është ndonjë gabim teknik e që duhet të ndryshohet si dhe Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa edhe kjo nuk aprovohet. Pra të dyja me siguri janë ndonjë gabim pasi shoh në pikat tjera që është vetëm shqyrtimi, kështu që është mirë që para se të fillojmë, këto të ndryshohen. Faleminderit
**Kryesuesi** – Është e vërtet z. Hoxha, kemi një lëshim teknik. Të nderuar kolegë, e qesim në votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, kolege këshilltarë, drejtorë dhe gjithë që janë prezentë në këtë sallë. Deshta me bo një ndërhyrje në procesverbalin në faqe 7, mendoj se është një gabim teknik që ishte pika e tretë e rendit të ditës në mbledhje për kornizë afatmesme buxhetore, tek diskutimi im te rreshti 19 ku thotë në mbledhjen e kaluar të kuvendit komunal e kemi aprovuar një kërkesë nga drejtori i Shëndetësisë një shume të hyrave prej 140,000 euro, e që në fakt do të duhej me qenë drejtori për financa, pra vetëm ky ndryshim duhet të bëhet.
**Trajko Shariq** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë kam një vërejtje të vogël në procesverbal, që kam parashtruar pyetje në mbledhje e kaluar mirëpo nuk është paraqitur përgjigja e nënkryetarit në procesverbal.
**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, anëtaret e kuvendit komunal, drejtorët, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë në diskutimin tim faqe 13,tek rreshti i 3-të konsideroj se fjalia duhet të jetë kështu falja e borgjeve të papaguara kurse aty shkruan falja e borgj të papaguara.
**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, sekretaria do të permisoj këto lëshime teknike. E qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Pyetjet dhe pergjigjet në pyetjet e Kuvendarëve.**

**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje të gjithëve. Fillimisht ju shpreh ngushëllime të gjithë familjareve që kanë humbur të dashurit e tyre si pasoj e pandemisë Covid-19. Pyetjen që deshta me adresua në lidhje me mbledhjen e kaluar që kishim sa i përket sinjalizimit të rrugëve ku është duke u ndërtuar aktualisht që e kam frekuentuar dy herë brenda muajit pra nuk është ndonjë hap në lidhje me këtë, pasi kjo është shume e rrezikshme sidomos natën ku në pjesën e Fortesës absolut nuk asnjë lloje ndërhyrje dhe kisha kërkua që kur të merren punët duhet të jeni me serioz dhe të implementohen pasi na premtuat ne muajin e kaluar se kjo do të realizohet në periudhën sa me shpejt që është e mundur.
**Masar Popaj** – Përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime ka të bëj për komisionin për emërtimin e rrugëve dhe pyes kete komision që të na jep një sqarim se deri ku kanë mbërri si dhe pse komisioni i ankesave nuk është funksional pasi që ka shume ankesa që nga fshati im Fortesë dhe shume fshatra përreth. Kërkoj që ky komision të mblidhet dhe të funksionalizohet që të shqyrtoj ankesat.
**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblistë. Unë deshta me ngritë një kërkesë, ku dihet se kemi filluar me projektin e ndriçimit publik në shumicën e vendbanimeve edhe është projekt shume i mirë dhe i qëlluar mirëpo deshta me ju drejtua drejtorit të shërbimeve publike z. Perparim Krasniqi se a është e mundur nëpër këto shtylla të vendosen shporta të vogla për mbeturina për shkak se përgjatë rrugës nuk kanë qytetaret se ku ti hedhin mbeturinat dhe vazhdojnë ti hedhin në rrugë dhe

përderisa ne nuk ofrojmë një vend se ku me i hedhë ato, atëherë qytetaret sigurisht do të vazhdojnë me i hedhë ne rruge dhe do të ishte një projekt i duhur dhe funksional që ta kemi një ambient sa me të pastër.
**Sali Sallteku** – Përshëndetje për të gjithë. Deshta me te përshëndet kryetarin e grupit parlamentar të AAK-së, dhe ta uroj për propozimin e tij pasi kurrë më mirë nuk folur dhe do të ishte mirë që deri ne fund të mos fol hiq, pasi vërtet e kisha edhe një propozim të tillë për vendosjen e shportave për mbeturina. Pa seriozisht është mirë me marr me përgjegjësi pasi njerëz nuk e kanë edhe kujdesin e duhur dhe hedhin gjësende nga dritarja e makinës dhe kjo është ide e qëlluar pasi nuk kushtojnë shume dhe krijon një kulturë të mirë për qytetaret për vetëdijesimin e hedhjes se mbeturinave ne vendin e caktuar.
**Rasim Fazliu** – Në bazë të planit të punës se kuvendit që e kemi hartuar në fillim edhe e kemi aprovuar do të ishte mirë që me i përfill pikat e rendit të ditës që i kemi paraparë gjatë muajve, e njëra nder to është edhe raporti i auditimit të përgjithshëm, që sigurisht ka pasur me ardh dhe qdo herë kemi raportua para kuvendit në muajin Korrik dhe kjo nuk ka ndodhur dhe tani deshta me shtrua si pyetje pse dhe ku është çështja.
**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Fazliu për pyetjen që parashtrove, me datën 14 të këtij muaji me ka ardh zyrtarisht raporti i auditorit të përgjithshëm mirëpo pasi që ishte me vonese dhe materiali për Mbledhje të KPF-së ishte i shpërndare atëherë nuk kemi pasur mundësi edhe me qit si pikë të rendit të ditës por për mbledhjen e ardhshme do të jep një përgjigje edhe drejtori apo nënkryetari dhe sigurisht që do ta kemi për mbledhjen e ardhshme.
**Rukije Krasniqi** – Faleminderit kryesues dhe përshëndetje për te gjithë të pranishmit në sallë. Unë vetëm e kisha një pyetje për drejtorin e DKA-së, qe nëse vazhdon mësimi online nga muaji shtator, cilat janë masat që duhet të ndërmerren për lehtësimin e punës se nxënësve dhe të mësimdhënësve sepse ka qenë një punë mjaft e vështirë të cilën e kemi kalua edhe kemi përfunduar vitin shkollor 2019/2020.
**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, te nderuar kolegë, anëtare të kuvendit komunal, monitorues dhe gjithë ju të pranishëm. Unë kisha disa pyetje, besoj që mbledhjen e kaluar nënkryetari ju ka përgjigj Ali Zhuniqit dhe s'di sa ju ka përgjigj ne çështjen e rrugës dhe unë e pash në procesverbal se ka dhënë disa sqarime në projektin e rrugës katër korsi por unë tani ju jap sqarime shtesë për rrugën 4 korsi e sidomos ne pjesën e Fortesës, ku sinjalizimi horizontal i rrugës ka qenë në dy anët me drita vezulluese dhe pjesa kryesore e rrugës është bërë me ngjyrë të verdhë që tregon se ka punime ne rrugë. Mirëpo ka fatkeqësisht ka dëmtime shume e po ashtu edhe vjedhje dhe normal që kompanitë hezitojnë vazhdimisht me investua mirëpo sidoqoftë une do të kerkojë shtesë kompanisë që me vendos ende sinjalizime dhe tabela informuese në atë segment rrugor pasi e dimë që është vendbanim. Sa i përket ndriçimit publik, unë i uroj Saliut,Dervishit,Bajramit ndriçimin e ri publik që kemi bërë dje në përurimin e fshatit Malësi e Vogël pra është vendosu mbi km ndriqim publik, pra edhe njëherë urime të gjithëve ndriçimin publik. Sa i përket shportave, e kemi fituar një grand nga GIZ-i gjerman prej 106,000 euro për vendosjen e shportave ne gjithë komunën e Rahovecit, që besoj që do të kërkoj edhe pjesën e shportave që vendosen në shtyllat e ndriçimit publik dhe besoj se si të lidhet kontrata me GIZ-in gjerman do të vendosim ato shporta.
**Trajko Shariq** – Po ndërlidhem me çështjen e ndriçimit publik pasi u përmend dhe dua të rikujtoj drejtorin që në disa pjesë të lagjes se epërme nuk është funksionale dhe ka nevojë për intervenim për ndriçim publik ne lagjen e epërme.
**Ali Zhuniqi** – Nuk e di sa jeni të informuar por kam pasur kërkesa prej disa banoreve që jetojnë në komunën e Rahovecit për shkak se fëmijët e tyre kanë me krye operimet në Maqedoni dhe kur dihet se Maqedonia ka një rregull në kuadër të respektimit të masave ndaj Covid-19 që duhet me pas një test. Unë për ata dy persona që me kanë kontaktuar, menjëherë e kam adresuar te kryetari dhe kisha kërkua se kur bëhet fjala për fëmijë në kuadër të përgjegjësive edhe institutit të shëndetit publik që i ka të deleguar nëpër komuna, duhet që këto kërkesa të merren me seriozisht e posaçërisht kur bëhet fjalë për fëmijë.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Deshta një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike për një sqarim të vogël rreth rrugës me katër korsi. Me intereson se ku fillon rruga me katër korsi, A fillon preh Viva Fresh Store në hyrje të qytetit apo nga Stonecastle të Bernjaka, pasi shohim atje se vetëm në njërën anë po kryhen punimet kurse ne anën tjetër jo dhe po ashtu janë ngritë shume pyetje prej qytetareve se vërtet nuk dihet se ku fillon ndërtimi i kësaj rruge dhe kisha pas dëshire që drejtori i Shërbimeve Publike z. Perparim Krasniqi me na dhanë një sqarim.
**Përparim Krasniqi** – Nëse me lejohet të i përgjigjem Trajkos për çështjen e ndriçimit publik. Ne jemi duke punuar pasi kontrata për ndriçim publik është në gjithë komunën e Rahovecit. Në Rahovec kemi 5 rruge kryesore që do të bëhet ndriçimi i ri publik në rrugën Bekim Isma që përfshihet edhe lagja e epërme do të bëhet ndriçimi i ri publik me shtylla metalike pra do të largohen shtyllat e vjetra për shkak se nuk ka ndriçim të mjaftueshëm aty dhe po shpresojmë që punën janë duke vazhduar neper të gjitha vendbanimet por që shpresojmë që deri ne fund të vitit të realizojmë shume projekte të ndriçimit publik por është me kontratë. Sa i përket rrugës 4 korsi i nderuari Munib Durguti, rruga prej Viva Fresh e deri ne Xerxe është 4 korsi ndërsa prej Viva fresh e deri ne rrugën e transitit është 3 korsi d.m.th. vetëm ana e djathtë e rrugës.
**Fatmir Iska** - Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar anëtare të kuvendit, drejtorë të drejtorive dhe gjithë të pranishëm në sallë. Në pyetjen e Masar Popaj te emërtimi i rrugëve, unë e di se ky komision ka pasur takim dhe kur të përfundon punën pasi është komision i ri dhe me pastaj është komisioni për ankesa që e di sa ka probleme pothuajse në çdo vendbanim. Edhe ne komisionin e vjetër isha edhe unë që kryesisht kanë qenë gabime teknike të mos përfshirjes që pastaj kanë rezultue edhe telashe tjera. Unë besoj që më ketë komision do të kryhen këto punë, sigurisht që do të ketë edhe ankesa dhe ato do të shqyrtohen. Tek pyetja e Rasim Fazliut, raporti i auditorit të përgjithshëm, ne këtë vizitë ka ardh me vonesë siç e përmendi edhe kryesuesi pasi që ne veçse e kishim shpërndare materialin për KPF-ë edhe shpresojmë që do ta shqyrtojmë në seancën e muajit Gusht. Por shume me rëndësi është që raporti i auditorit të përgjithshëm ka dalë shume mirë me disa të gjetura normal që ato do të diskutojmë bashkërisht. Tek pyetja e Rukije Krasniqit, mësimi online që të gjithë jemi të vetëdijshëm se janë vendimet e qeverisë në bashkëpunim me drejtoritë komunale të Arsimit, a do të jetë i përzier ky mësim online brenda javës, ende nuk ka vendosur as Ministria e as DKA-ja që në bashkëpunim do të shikojmë, pasi të gjithë e dimë se si ka vijuar ky proces.
**Kryesuesi** – Faleminderit shume nënkryetar, të nderuar kolegë kuvendarë nuk po shoh tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. **Shqyrtimi i Raportit të Punës se Kryetarit të Komunës për periudhën 6-mujore Janar-Qershor 2020.**

**Fatmir Iska** – Unë do të jem i shkurtër meqenëse është edhe raporti dhe e keni para vetes të gjithë. Në këtë raport 6-mujorë për vitin 2020 janë të pasqyruara synimet, prioritetet, punët e kryera dhe po ashtu raporti është i bazuar në bazë të planit të punës se kryetarit të komunës për vitin 2020, pra në këtë 6-mujorin e parë. Ky raport është i publikuar në webfaqen e komunës ku janë të gjitha raportet e njësive apo zyrës se kryetarit pastaj të drejtorive komunale. Shërbimet janë të pasqyruara qoftë në formë tabelore apo në formë tjetër. Unë nuk po dua të zgjatem me shume përveç se ju ftojë për diskutim, sigurisht që dikush mundet me pas vërejtjet e tij rreth raportit që ndoshta mundet me qen voluminoz apo i shkurtër por ne jemi përpjekur me qenë më të qartë dhe me konciz në punët e kryera. Përndryshe edhe shume punë të tjera kanë me u krye brenda 6-mujorit të dytë dhe sigurisht që edhe për atë do të raportojmë në fund të këtij viti. Ju ftojë për diskutim.
**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar. E falënderojmë kryetarin për sjelljen e këtij raporti mjaft i gjerë që përfshin aktivitetet dhe punët e gjitha drejtorive qoftë edhe sektorëve që operojnë në kuadër të zyrës se Kryetarit. Gjate kësaj periudhe ka pasur projekte të rëndësishme që janë zhvilluar dhe janë përfunduar mirëpo ka edhe të atillë që janë në vazhdim e sipër. Kemi pae projekte me rëndësi për qytetaret në të gjitha vendbanimet që po i theksoj disa siç është ndriçimi publik ne disa vendbanime, uji i pijes në fshatin Pastasel

një projekt jetik për qytetaret e këtij vendbanimi po ashtu rregullimi i rrugëve fushore është një nga projektet që është pritur me se miri nga fermerët sepse vërtet ka qenë i domosdoshëm një projekt i tillë dhe shpresojmë që të vazhdoj edhe me tutje. Kemi projektin e hapësirave të gjelbëruara siç janë ndërtimi i parqeve si projekt me rëndësi sepse do të ndikoj direkt në përmasimin e ambientit ku ne jetojmë mirëpo një vërejtje të vogël sepse kur të ndërtohen këto parqe do ishte mirë me ndërtua edhe ka një kënd të lojërave për fëmijë sepse edhe me rregulloren per te drejtat e fëmijëve i kemi paraparë që duhet të ofrojmë hapësira për rekreacion të fëmijëve. Gjithashtu kemi projekte të rëndësishme edhe ne fushën e shëndetësisë siç është ndërtimi i ambulantes se re në fshatin Çifllak dhe fillimi i ndërtimit të ambulantes se re në fshatin Opterushe. Tani nuk po hie që të përmend të gjitha, i shkoqita vetëm disa prej tyre mirëpo me te vërtet janë bërë punë të mëdha dhe të mira që ndikojnë direkt në jetën e qytetareve.

**Fehmi Cena** - Ne përpara e kemi raportin 6-mujorë të punës se qeverisë lokale dhe Kryetarit për këtë vite. Është e vërtet se është një raport mjaft voluminoz dhe gjithëpërfshirës ku përfshihen aktivitetet e zyrave edhe të kryetarit edhe të gjitha drejtorive. Gjate leximit atë që kemi mundur me pae, kemi vërejt se ka mjaft që janë krye dhe ka rezultate pozitive edhe për çka ne i përgëzojmë për këto punë që janë kryer por natyrisht që kemi edhe ato sugjerimet tona edhe vërejtjet tona për punët të cilat ose janë krye përgjysmë ose nuk janë krye si duhet. Unë po filloj me faqen 4,tek pika plani lokal i veprimit në mjedise përmendet, po ashtu unë do të shtoja gjithashtu është edhe plani komunal për eficiencë të energjisë. Ne i kemi aprovuar në Kuvend këto dy plane edhe e kemi cekur se janë plane strategjike që përmes se cilëve komuna mundet me marr me thithë edhe donacione për realizimin e projekteve qoftë si grande nga niveli qendror qoftë edhe donacione të jashtme. Po ashtu do të doja të kishte pasur edhe me shume projekte pasi edhe atëherë kemi thene që qeveria duhet të bëj projekte të mira të sakta bindëse që në mënyre që të thithë buxhete edhe nga donacionet. Në fakt në këtë raport unë sa kam mundur me pae është një projekt aty që përmendet për arsim ne shkolla në pjesën e energjisë eficience por për të tjera projekte do të duhej të kishte me shume në këtë drejtim. Pika tjetër ne vazhdim është përmbyllja e projektit të pompave për ujin e pijes në fshatin Pastasel që është kryer pasi siç dihet është prerë shiriti mirëpo ne Komiteti për Politike dhe Financa para disa dite që kemi mbajtur dëgjimet buxhetore publike, na është thënë nga qytetaret aty se ata ende nuk kanë ujë të pijes d.m.th. deri ku ka arrit kjo edhe pse ata nuk kanë ujë të pijes ende. Rreth menaxhimit të pandemisë, e di se janë bërë mjaft punë të mira sidomos në këtë pjesën është formuar shtabi i emergjencës i cili po e mbikëqyrë situatën në komunën tonë. Tani e dimë se si është situata në komunën tonë jo edhe aq e mirë pasi edhe ne si komunë jemi përfshije me mjaft raste që kemi të prekur nga kjo sëmundje. Natyrisht që komuna nuk i ka në dorën e saj të gjitha këto gjëra mirëpo janë ato veprimet të cilat është duke i bërë mirë si dezinfektimi i lokaleve, i ambulancave, prezenca e tuneleve të dezinfektimit po ashtu është bërë mirë që është sjellë edhe ne oborrin e QKMF-së edhe pse e kemi kërkuar edhe me herët, natyrisht mua nuk po me vjen mirë që nuk po e shoh këtu në oborrin e Komunës pasi mendoj se do të duhej me qenë edhe këtu sepse është e nevojshme dhe ka frekuentim të qytetareve edhe duke marr parasysh situatën epidemiologjike në të cilën jemi do të duhej që të ketë me shume, bilum unë propozoj që në çdo qendër të mjekësisë familjare të ketë nga një tunel i dezinfektimit sepse është shume i rëndësishëm. Ne i kemi ndaje 10,000euro që është kërkuar edhe nga Kryetari për ndarjen e kësaj shume për menaxhimin e kësaj çështje, mendoj se është bërë mirë edhe pse nuk mjaftojnë sepse ka nevojë të ndahen edhe me tepër mjete. Por këtu dikun ceket se këto mjete po përdoren për furnizim me barna dhe përkrahje për raste sociale. Mendoj se nuk është shume e madhe se pse kjo përkrahje socialë do të duhej që të bëhet përkrahja e punëtorëve shëndetësorë në kuptimin e furnizimit me pajisje për mbrojtje edhe pse jo për motivim apo stimulim të punëtorëve duke qenë se janë vërtet ne vijën e parë të frontit që është mjaft e rrezikshme për momentin. Ato dobësitë që i kemi kaluar në pandemi do të thosha se fillimi ka qenë paksa i vështirë pasi kemi pasur mungesë të pajisjeve për mbrojtje të personelit dhe ndoshta ne fillim edhe nuk është kuptua edhe rëndësia e kësaj

pandemi. Gjithashtu e dimë se një kohë ka pasur edhe ardhje të pacienteve edhe nga komunat e karantinuara, gjë që kanë paraqitur rrezik për përhapjen e sëmundjes edhe në komunën tonë. Po ashtu një vërejtje e kam tek bizneset duke përfshije sidomos këtë të gastrologjisë pasi shohim edhe sot e kësaj dite tek ata që aspak nuk i respektojnë rekomandimet që vinë nga niveli qendrorë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti kombëtarë i shëndetit publik, që edhe sot e kësaj dite kur shkojmë shohim klientët se ata nuk kanë maska dhe po e e potencoj edhe njëherë se si profesionistë që përdorimi i maskave dhe respektimi i këtyre rregullave është shume i rëndësishëm. Një pikë tjetër është lidhja e kontratës për mbjelljen e drunjtëve dekorativ, që e keni cekur dikun 10,000 euro dhe sa e di unë ky projekt kushton afërsisht 50,000 euro. Vërejtja ime është te ajo se ne i shohim se këta drunjtë dekorativ sidomos përgjatë rrugëve në mes të vendbanimeve shumica prej tyre janë tharë. Këtë çështje e kam potencuar edhe me përpara edhe përgjigja nga drejtori i shërbimeve publike ka qenë që kompanitë që merren me to diku në kontratë është që për 3 vjet ata duhet me u përkujdes edhe për mirëmbajtjen e tyre sepse e dimë se nëse nuk ka përkujdesje atëherë gjysma e tyre me siguri do të thahet edhe do të thotë ne llogarisim se edhe kjo gjysma e buxhetit do të shkoj huqe. Tek Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport është cekur restaurimi i monumenteve i objekteve kulturore që realisht nuk po shoh diçka tjetër pos bunarit të madhe në Ratkoc që është cekur se është bërë restaurimi i tij dhe diçka tjetër nuk po shoh në këtë periudhë kohore që është restauruar. Unë jam ithtar i asaj që monumentet kulturore historike të mbrohen dhe kam kërkuar edhe me përpara që të bëhet një listë komplete ku do të përfshiheshin të gjitha objektet të rëndësisë kulturore dhe historike duke qenë se dhëmbi i kohës po i shkatërron çdo ditë e me shumë. Nuk kam parë që është punuar në këtë drejtim ose se paku që është punuar me tepër ne restaurimin e tyre. Kam cekur edhe atëherë edhe tash po e ceki se ka edhe ne qytete por ndoshta edhe neper fshatra janë disa shtëpi të vjetra të cilat kanë strukturën e vjetër karakteristike edhe do të duheshin me qenë nen mbrojtje edhe me u përkujdes edhe për ato pak që kanë mbetur që të mos shkatërrohen plotësisht. Kur jemi te kjo drejtori, tek subvencionimi i OJQ-ve kemi kërkuar edhe me përpara që drejtoria duhet të kërkoj raporte për projektet që po financohen me OJQ-të. Cekët aty në raportet e kësaj drejtorie se është bërë një raport mirëpo ne nuk i kemi të dhënat se sa kjo drejtori është e kënaqur me projektet që po realizohen dhe për këto para që po shpenzohen.

**Florida Bajraktari** – Faleminderit kryesues, unë e kam vetëm një pyetje tek drejtoria për shëndetësi, pasi këtu askund nuk përmendët reparti për dializë. Pra është fundi i vitit të tretë të qeverisjes edhe ende nuk është aktivizuar kjo qendër. Pyetja ime do ishte se kur do të aktivizohet reparti për dializë në Rahovec.

**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë t pranishmit. Unë do të përqendrohem kryesisht ne raportin e Kryetarit sepse raporti i Kryetarit po i përfshin edhe drejtoritë e tjera d.m.th. i përmbledh pothuajse të gjitha. Sipas raportit të Kryetarit shumë punë janë bërë të mira edhe qytetaret e komunës tonë kanë pasur përfitime nga investimet e buxhetit të Komunës neper vendet e tyre por megjithatë unë kam vërejtjet e mia që ka pasur mundësi me u punua edhe me tepër që me shtrie teren edhe me tepër për nevoja të qytetareve kur kemi parasysh që tash kur ishim ne dëgjimet buxhetore e pamë që përkundër kësaj nevojat e qytetareve ishin të mëdha, e aq me tepër mua me bëri përshtypje në këtë raport të Kryetarit po me duket mua se nuk është fokusimi i mjaftueshëm për disa drejtime aty që qytetaret kanë nevojë e sidomos për ujë dhe për kanalizime. E pamë që kish vende që kanë nevojë për ujë edhe tash ne shek..21 ka ende lokalitete që kanë nevoja për ujë. Ndërsa sa i takon ujërave të zeza, edhe kjo është nevojë sepse shume lagje dhe pjesë të fshatrave ka ende që nuk kanë mundësi që ujërat e zeza të i trajtojnë ose të i largojnë nga vendbanimet e tyre. Po aq e rëndësishme mendoj unë dhe detyrë e kryetarit që trajtimi i ujërave të zeza është problem shtetërorë pra republikan mirëpo nuk kam parë ndonjë lëvizje që çfarë të bëjmë me ujërat e zeza sepse e kam thënë edhe me herët që këto ujëra që vetëm qytetari i Rahovecit që shkon teposhtë e që derdhen në Drinin e Bardh pastaj Fortesa,Xerxa,Krusha e Madhe, pra duhet të mendojmë njëherë e mirë sepse po e ndotim ambientin shume edhe kjo është në të keqen e qytetareve tanë. Përpos kësaj e pash në raportin e kryetarit se inspekcionin do ta forcojmë pasi do të ketë

punë me shume dhe do të del ne teren me shume mirëpo në bazë të dënimeve që i ka bërë, unë po shoh që qytetaret shume mirë qëndrojnë dhe nuk bëjnë gabime e nuk veprojnë jashtëligjshëm mirëpo e vërteta është se unë shoh rrugës se trotuaret janë të zëna me artikuj ushqimorë që shesin njerëzit në trotuare, gjithashtu shoh mbetje të ngurta apo bërllogë nëpër çdo pjesë të komunës tonë të cilat ju i largoni shpesh mirëpo megjithatë është një veprim i domosdoshëm i inspekcionit që ti ruaj këta keqbërës edhe ndotës të ambientit sepse me te vërtet është koha e fundit të mendohet për ambientin. Fokusi i veçantë siç e kam parë aty është edhe te bujqësia por problemi kryesor në bujqësi sot nuk është qe atyre të ju ofrojmë mjete për me punua sepse vegla nuk po them që kanë mirëpo kanë mjaftueshëm për me punua edhe me prodhua prodhime bujqësore por është problemi i tregut pastaj i ekonomisë ose e përpunimit të këtyre prodhimeve. Pra Kryetari është mirë me u interesua me tepër që të sjellë[ donatorë ose investues që do të investojnë në përpunimin e pemëve dhe perimeve. E kam cekur edhe njëherë në një takim tjetër pasi nuk ka mjaftueshëm aktivitet për punën e mbrojtjes nga breshëri d.m.th. e tërë puna e buqëve në komunën tonë është në mëshirën e motit, Ju keni thënë se nuk lejohet për shkak se KFOR-i është përgjegjës për hapësirën mirëpo ata duhet të na japin një zgjidhje se si i bëjnë ata në Gjermani,Austri apo në Zvicër dhe si i mbrojnë prodhimet e tyre nga breshëri nëse nuk na lejojnë neve me ata topat që e gjuajnë breshëri. Nëse e marrin në mënyre të përgjithësuar atëherë unë kisha thënë edhe për arsimin që e kemi Shkollën Fillore ne Gexhe të pariparuar dhe kulmi i saj është i dëmtuar dhe kemi tërhequr vërejtjen disa here dhe përsëri ajo punë nuk është kryer dhe nuk e di se kur do të kryhet pasi nuk e shoh askund. Pastaj kemi disa projekte per disa trotuare që kanë pasur me u bo, pastaj të Gradishi nuk janë bërë, pastaj oborri i Shkollës në Malësi të Vogël nuk është bërë dhe kam një vërejtje edhe tek investimet që po bëhen Kryetar, pasi shpesh na kanë pyetur qytetaret tash në kohen e fundit se cilat janë kriteret për investime të komunës. Edhe unë mendoj që kriteri parë është nevoja e domosdoshme e një lokaliteti apo komuniteti që duhet me investua aty si uji,kanalizimi,rruga etj. Kriteri i dytë është e mira e tyre që sa me shume njerëz me pas që me iu shfrytëzua edhe kriteri i tretë është se sa kontribuon me te hyrat në Komunë d.m.th. taksapaguesit e komunës. Prandaj unë mendoj se ju nuk e keni përdor këtë mjaftueshëm edhe e ka disa lokalitete të cilat që të tri këto kritere i plotësojnë edhe nuk keni ndërhyje mjaftueshëm. Po ashtu e kam një pyetje, ju me UN-Habitatin ju jeni duke bërë një projekt për qendrën poshtë atje, por kur e shoh atje Kultura që do të investoni në fushën sportive, nuk e di a do të hynë edhe ajo fushë ne atë projekte, nëse nuk do të mbetet ajo fushë aty atëherë cila është arsyeja me investua prapë aty. Unë mendoj që edhe projektet që i bëni do ishte mirë të bëhen edhe me metra katror dhe metër gjatësi sepse po dalin shume projekte aty ndërsa kur i shikon me metër gjatësi atëherë nuk janë shume edhe sigurisht duhet të kihet parasysh se kudo që shkon nëpër fshatra kanë nevojë për rrugë, kanalizime, ujë dhe shume investime tjera.

**Kryetari** – Faleminderit shume për diskutimet që keni bërë për raportin 6-mujorë të punës për vitin 2020 pra për 6-mujorine parë. Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtoret e drejtorive, anëtaret e kuvendit të komunës, përfaqësuesit që e përcjellin këtë seancë dhe gjithë të pranishmit në sallë. Raporti mendoj se maksimalisht është i qartë dhe i saktë, mund të jet i zgjeruar por është i thjeshtë në kuptimin e qartësisë. Raporti përfshin siç e tha edhe nënkryetari krejt edhe është i publikuar me kohë sipas standardeve të përformances komunale për qeverisje këtu dhe besoj që jemi mirë edhe me transparencë e po ashtu edhe me performancë. Te pyetja z. Fehmi Cena për 10,000 euro që shtruar çështjen se çka bëhet me atë shumë. Faleminderit prej kuvendit të Komunës pasi ato nuk përdoren për ndihma momentale dhe as për sëmundje sepse është fonde i veçantë sepse është kategoria e subvencioneve që përdorën për ato qëllime edhe janë në drejtorinë e shëndetësisë, mund të përdoren për ndonjë masë mbrojtëse për pajisje mbrojtëse për sa i takon mirorganizimit të QKMF-së për rrethana të reja por jo për me shume. Uji i pijes në fshatin Pastasel kur keni qenë ju n dëgjime publike vërtet e kemi pre shiritin se bashku me KRU.Gjakova pasi kemi marrëdhënie të atillë pasi ne kontribuojmë në proces por ata janë përgjegjës për furnizim me ujë të pijes, edhe me ligjin në

fuqi. Prej prerjes se shiritit e deri ne ditët e sotme, ata i kanë krye ato punët e veta teknike që lidhen me mungesën e pamjaftueshmërinë e furnizimit të gypit me ujë e po ashtu të stacionit të pompave etj. punë këto që realisht i kanë pasur ata dhe që i ka krye komuna e Rahovecit në kohën e qeverisjes se kaluar por me gjasë ka pasur dëmtime ne gupe edhe ska pasur ujë të mjaftueshëm. Tash janë përfunduar të gjitha ato edhe uji është lëshuar dhe gjithçka është në rregull për sa i takon furnizimit të rezervuarit kurse stacioni pompave është funksional dhe kanë filluar veç mu kyq edhe familjet, edhe tash është krejt çfar ka mbetur pra kyçja e familjeve me sistemin e ujit të pijes për të gjithë banoret e fshatit Pastasel, bile mendohet se sipas informatave që kam edhe nga drejtori i shërbimeve publike edhe nga KRU.Gjakova dhe drejtuesit e kësaj kompanie ka me pas ujë të pijes mjaftueshëm, gjë që kanë probleme pothuajse të gjitha fshatrat përreth. Për tunelet dezinfektuese, ne këto i kemi donacion pra nuk kemi hargjue mjete të buxhetit të Komunës dhe vërtet këtë tunele që kemi pasur këtu e kemi dergue në QKMF. Ka një tendencë për me u vetdisiplinue në radhë të parë zyrtarët e komunës por edhe qytetaret të cilët po vijnë me marr shërbime këtu. Pra ndërmjet këtyre dy mbledhjeve që po i mbajmë në kuvend të komunës,po besoj qe keni vërejte shume pak njerzë me maske kurse tash edhe kryetari i komunës është me maskë. Pra kemi disa rregulla t reja dhe perveq tjerash ka me shume maska që përdorin,ka me shume disiplinë dhe me shume ndjenjë të përgjegjësisë edh nga ata që vijnë me kerkue shërbime ose me marr shërbime këtu edhe nga zyrtaret e komunës. Po ashtu edhe ne QKMF, bile edhe kusht i domosdoshëm do të ishte shume ndjeshme dhe e rendë nëse do të kishim infeksion nga stafi shëndetësore, pasi është mirë e u ruajte sidomos personeli shëndetësor sepse është domosdoshëm. Ne nuk kemi pasur ndonjë telashe shume të madhe me infeksionin sa i takon pasi nuk e ka përfshije stafin tonë shëndetësor por ju e dini informatat si janë neper Kosovë pasi janë një numër i madhe i mjekeve dhe teknikeve të infektuar që madje kemi edhe raste vdekje edhe te punëtorëve tanë shëndetësore. Për pandeminë, ky raport përfshin nga data 15 Mars edhe aktivitete, dinamika, përpjekje, tentativa, angazhime të veçanta për tu përballur me pandeminë, edhe këto janë evidente që ndoshta nuk mund te jenë deri ne fund të përshkruara ne raport sepse ka një informatë me te veçantë rreth kësaj teme por jemi munduar të përcjellim edhe të kontribuojmë ne vazhdimësi që përballja me pandeminë sa me e favorshme për ne dhe ta luftojmë sa me suksesshëm me Covid-19. Pra paratë e ndara për Covid-19 që ja kemi propozua dhe i ka ndae kuvendi, nuk janë të mjaftueshme por nuk janë përdorur për ato qëllime. Drunjtë dekorues-e vërteta është që kompanitë të cilat kanë krijua marrëdhënie kontraktuale me komunën e Rahovecit pasi që kanë kontratë dhe janë obligative, unë nuk kam dëshire me u thae mirëpo ata e mbajnë përgjegjësinë dhe asnjë shumë nuk hargjohet për ato që dështojnë, duhet ta kuptojmë se z. Cena tha që shkon edhe gjysma tjetër e buxhetit dhe unë i themë se nuk do shpenzohet asnjë shume për këtë. Pra brenda kësaj periudhë për te cilën fole, ata janë përgjegjës për mirëmbajtje dhe për dështimet eventuale të drunjtëve dekorues, pra kompania përgjigjet nëse kanë llogari me u përgjigj ne kërkesat tona pasi të gjitha janë të numëruara dhe përgjegjës për këto është drejtori i urbanizmit edhe sigurisht se janë të evidentuara se sa është numri, ku janë të mbjella, ne sa lokalitete, në cilat pjesë dhe gjithçka është e shënuar. Pra sigurisht që do te kemi mbikëqyrje të vazhdueshme dhe tani jemi ne fazën e verës dhe tani nuk parashihet m u përmirësimi ose zëvendësimi i tyre mirëpo në stinën e vjeshtës ne shpresojmë me i zëvendësua krejt ato që janë thae, megjithëse ata thonë sipas tyre nuk thahen mirëpo është çështje që ja vlen me u ngritë si shqetësim por komuna jonë paguan vetëm për pjesën e parë ndërsa për pjesën që është periudha e mirëmbajtjes nuk paguan për ato sepse është e precizuar qartë në kontratë. Te restaurimi i monumenteve kulturore historike- ndoshta ka mundur me figurua bunari i madhe pasi kjo fazë e ka përfshije tani por ka restaurim apo përpjekje për ti riparuar objektet dhe me një liste të madhe të objekteve ne kemi kontratë pra janë riparuar ne Nashpall,në Rahovec, në Ratkoc dhe në shume pozicione tjera ku ka një listë të objekteve të cilat janë trajtuar, me një pjese tjetër të objekteve kemi probleme, ne zakonisht i ftojmë institutin për mbrojtjen e monumenteve dhe është njëfarë korrelacioni që mbahet edhe me qendrën edhe me institutin

rajonal të Prizrenit, d.m.th. është e vërtete që duhet me pas kujdes kur bëhet fjalë për ndonjë mulli të vjetër apo ndonjë objekt të vjetër që me pas shume kujdes qe a do shkohet ne konservim, restaurim apo ne riparim dhe në një monument e kemi pezullua aktivitetin për shkak të një gjurme që ndoshta ka qenë e drejtë se sikur ta kishin bërë ata që kanë njohuri krejt ne rregull mirëpo kur bëjnë diçka ata që nuk kanë njohuri atëherë duhet me ndërpre dhe duhet me prit përgjigje prej institucionit, nëse përgjegjëseve të institucionit të fushës që jo rrallë paraqiten edhe janë fate burokratike edhe që për një rekomandim edhe të vonojnë shumë. Te lista e objekteve të mbrojtura – te lista e objekteve të trashëgimisë kulturore historike, unë besoj që drejtoria e kulturës për herë të parë ka filluar me bo një punë të madhe dhe është duke evidentuar edhe objektet e vjetra ose monumentet e vjetra por edhe është duke i vendosë në hartë edhe objektet e reja ose monumentet e reja edhe janë duke bërë një punë të cilën ne po përpiqemi me futë edhe në planin e ri zhvillimorë komunal edhe hartën zonale që pastaj sigurisht me u pjesë edhe e planit ose objektivave për ti futur edhe në mbrojtjen e institutit të monumenteve qoftë ai rajonal apo në këshillin e trashëgimisë bashke me institutin qendror për mbrojtjen e monumenteve. Besoj që ju e keni pasur një informatë më herët, që tani keni me pas informatë shumë me te plotë për secilin objekt që evidentohet gjithashtu edhe një historik të shkurtër të atij objekti apo atij monumenti. Te subvencionimi i OJQ-ve, nuk ka mundësi një OJQ që përfiton subvencione nga zyra e kryetarit apo në këtë rast nga drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që nuk sjellë një raport, pasi është i obliguar edhe i kanë sjell raportet tash. Lista e përfituesve të OJQ-ve nga subvencionet e Kulturës, rinisë dhe sportit është publike edhe ate mund ta shihni dhe lexoni kurdo nëse futeni ne webfaqe të Komunës sepse ne jemi të obliguar me publikua edhe ne webfaqe listën e përfituesve edhe të bursave, edhe të OJQ-ve. Të fermerëve edhe gjithçka jemi të obliguar me publikua sipas kërkesës dhe zotimit tonë për transparencë por edhe sipas ligjit. Pra secila organizatë, grup i organizuar, shoqëria civile dhe kushdo që ka përfitua ka sjellë raporte në Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Tash a duhet të përfshihen në raportin e punës 6-mujore këto raporte të përfituesve, unë mendoj se jo pasi që ne e kemi kurdo që ju e vlerësoni Drejtoria e Kulturës Rinise dhe Sportit mundet me prue një informatë të detajuar se cilat kanë kriteret të cilat janë përdorur për ti vlerësuar apo për te nxjerrë rekomandimet e veçanta se kush do të jenë përfituesit e subvencioneve. Reparti i hemodializes –ende nuk e kemi hapur, ka pasur një tentativë për hapje të përkohshme vetëm në kushte pandemie dhe ne nuk e kemi pranuar dhe e kemi refuzuar vendimin e Ministrit Vitija sepse nuk mundet me u tall askush me qytetaret e komunës se Rahovecit, kinse po e hapim për pandemi edhe po i sjellim pacientet prej Suharekës e Malishevës edhe ne momentin që konstatohet se nuk ka pandemi atëherë atyre pacienteve me hemidializë shkoni ku jeni kon me përpara. Kto gjera për mua janë të papranueshme pasi që këto teknikalitete edhe i kuptoj mirë edhe nuk i pranoj asnjëherë deri sa unë jam kryetar komune. Këto janë veç lojëra dhe që per mua janë të papranueshme se nuk guxoj me hie dhe me marr përgjegjësi të tilla. Tani është ndrrue vendimi dhe jemi në përpjekje dhe kam luftuar n baza ligjore me zyrën ligjore të Ministrisë se Shëndetësisë që madje kemi pasur situata jo të lehta sepse ata kanë deshtë edhe me i frikësua mjekët tanë që ne do vijmë edhe e hapim me dhunë repartin. Pra jemi ne përpjekje për me sigurue, është marrë vendimi për hapje të përhershme të repartit të hemodializes. Se kur do të bëhet funksional, besoni se ne këtë situatë as Ministri i Shëndetësisë nuk mundet me ditë e mos të flasim kryetari i komunës që nuk është përgjegjës direkt për shkak se kryetari i Komunës veç ofron logjistiken e nevojshme teknike për me hap këtë repart. Ne jemi të interesuar me hap dhe moti ka qenë qëllimi me hapë edhe kërkesë për ta hapur mirëpo ne momentin kur të permisohet situata epidemiologjike në Kosovë atëherë me siguri mund ta shohin të arsyeshme edhe me prioritet të lartë hapjen e repartit të hemodializes ne Rahovec. Është përgjegjësi e spitalit rajonal të Prizrenit edhe Ministrisë se Shëndetësisë po ashtu edhe ne jemi partner edhe drejtoria e jonë e Shëndetësisë pastaj Kryetari i Komunës është partner shume serioz në krejt angazhimet që i ka për me hap sa me shpejt por sigurisht për me bo të përhershme e jo me bo hajgare e me u tallë me njerëzit për shkak te gjendjes se vështire njëherë në Rahovec e pastaj në Prizren. Pra

këto situata ne nuk i kemi pranua edhe kemi shkresa dhe nëse ndonjëherë me kërkua nga unë raport rreth kësaj atëherë unë do ju dokumentoj me letra krejt luftën ligjore që kemi bërë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe njëfarë përpjekje e tyre me u sjellë jo mirë me komunën e Rahovecit. Por nuk e kemi lejuar edhe kemi bërë shume mirë që nuk e kemi lejuar dhe nuk do të lejoj situata që dikush me investimet e komunës se Rahovecit në repartin që e ka kompletua komuna e Rahovecit, me pajisjet që janë sjellë nga buxheti i komunës se Rahovecit me diktua dikush si autoritet edhe me marr vendime arbitrare dhe sigurisht unë aso vendime unë nuk zbatoj. Por kjo është konstatuar se ishte një përpjekje sa për konsum të brendshëm e jo përpjekje serioze dhe nuk kemi lejuar. Besoj që është mirë me u hap sa me shpejt edhe reparti është komplet me te gjitha pajisjet, stafi i repartit duhet me u rekrutua nga ana e spitalit rajonal edhe sa me mirë dhe shpejt që hapet do të jetë me mirë. Tek pyetja e Dervish Çadrakut – punët e kryera dhe që janë duke u kryer edhe nevojat e qytetareve janë në shpërputhje. Kush nuk e ka kuptua këtë fakte mendoj që nuk është ne thelbin e realitetit sa duhet ose vërtet nevojat janë shume më të mëdha po ashtu kërkesat janë shume me te mëdha e ndoshta mundësit për realizimin e investimeve publike janë me të vogla për shkak të mundësive buxhetore edhe kapaciteteve që i kemi sot. Ujërat e zeza - mjaft kemi bërë në kanalizimin e ujërave të zeza në vendosjen neper gypa të ujërave të zeza. Kemi problem me impiante pasi vërtet komuna jonë ka probleme serioze ne trajtim të ujërave të zeza, për ujërat që vendosen neper gypa ato derdhen dikun në lumë, ne përrua ose dikun ku nuk duhet mirëpo aty ku derdhen kundërmojnë erë të keqe për shëndetin e qytetareve. Ne kemi provua në impiantin e ujërave të zeza që kushton shume dhe nuk e kemi fitua këtë të drejtë Komuna jonë dhe kur kam fillua mandatin në vitin 2017 kam menduar që kemi fitua, po ashtu edhe ne debatin që kishim në debate publike për zgjedhje e kemi konsiderua se është temë e mbyllur por nuk ish kon ashtu pra dikush komunën e Rahovecit e ka gënjyer pasi kolektori i ujërave të zeza nuk ka qenë i fituar asnjëherë ose nuk ka qenë temë për me fillua me u konkretizua si nevojë e madhe jetike e qytetareve të Komunës se Rahovecit. Tash me impiante të vogla edhe të mesme, ne po provojmë ashtu diçka siç kemi vepruar ne fshatin Kramovik me UNDP-në, po ashtu mund të bëjmë edhe ne pjesë të tjera apo pika të tjera kritike ku është nevojë jetike për trajtim me adekuat të ujërave të zeza në lokalitete. E kemi futur si kodë në sistem të Ministrisë se Ekonomisë dhe Ambientit edhe do të ishte mirë impiante të vogla ne ato pjesë me mbërri me bo ku ka vërtet nevojë shumë të madhe. Te inspektoret – ju e dini se inspektoret, policia, punëtorët shëndetësorë edhe plot partner tjerë kanë kontribute të jashtëzakonshme në periudhën që jemi tani në kohë pandemie, ndoshta ne do të kishim shume pakënaqësi kur nuk është periudhë pandemie për shkak se ndoshta nuk ka stafe të mjaftueshëm, për shkak se ndoshta nuk e kryen punën sa kërkohet edhe sa duhet ndërsa në kohën e pandemisë, unë mendoj se inspektoret e komunës se Rahovecit kanë krye punë të vazhdueshme edhe jashtë orarit të punës, pastaj kanë pasur probleme me stafe, siç e dini një punëtorë i komunës ka vdekur, disa të tjerë janë infektuar por përballje sa i takon ushtrimit të përgjegjësive të veta kanë qenë aktiv gjate gjithë kohës se pandemisë e sigurisht edhe tash vazhdojnë me kapacitetet që i kanë sot. Sigurisht se nuk janë trajtuar sa duhet pasi vetëm njëherë janë trajtuar në kuadër të pakos emergjente dhe nëse rishikimi i buxhetit kalon në kuvendë të Kosovës ndoshta mund të trajtohen mjekët dhe infermierët e sigurisht edhe inspektoret e policia por punën unë po mendoj se janë duke u munduar ta kryejnë sa më mirë që është e mundur ndoshta edhe rrethanat pandemike po diktojnë ata me qenë më të mobilizuar, e po ashtu edhe kërkesat tona po diktojnë që ata me qenë me te organizuar edhe funksional madje punojnë edhe 24 orë pra edhe gjate ditës edhe natën edhe sipas rrethanave po ashtu bëjnë edhe veprime të kombinuara bashke me inspektoret sanitarë të nivelit qendrorë që marrin pjese në aksione të ndryshme. Me UN-Habitatin ne kemi një marrveshje pasi me 1 Shtator pritet me u shpallë konkursi i projektimit për sheshin qendror të qytetit, ku përfshin prej palestrës pastaj gjithë zonën që është parkingu pastaj stadiumi, tregu, pastaj aty ku është kafiteria Hardhia dhe gjithë objektet e vjetra që janë, pastaj parkingun e hotel Parkut e madje mund të përfshin ndoshta edhe pjesën e parkut Toni e Mici. Pra ne me UN-Habitatin kemi ndërmarrë të gjitha

veprimet që procesi me qenë transparent, kushtet për shpalljen e konkursit ndërkombëtar të projektimit me qenë transparente, ata i kanë bërë disa veprime edhe në kohën e pandemisë e bëjnë sa me gjithëpërfshirëse edhe transparente gjithë procesin dhe me 1 shtator shpallet konkursi ndërkombëtar i projektimit pastaj projekti me i mirë zgjidhet nga juria që është kryesisht nga UN-Habitatit me ndonjë arkitekt që kryesisht mundet me pas komuna e jonë që kryesisht vendimin ata e marrin dhe pas përzgjedhjes se projektit më të mirë ideor, atij që e ka fitua të drejtën i jepet mundësia me bo projektin detale në projektin kryesorë. Vitin e ardhshëm parashihen veprime konkrete për sa i takon ekzekutimit të projektit me te mirë që zgjidhet midis komunës se Rahovecit dhe UN-Habitatit. Fusha e futbollit do të largohet ehe siç e dini është vendosur tek epopeja e UÇK-së,pasi quhet si zone turistike me planin e vjetër zhvillimorë komunal dhe aty janë të ndara sipërfaqet kurse këtu kanë qenë pronë e agjensionit pyjorë dhe ne e kemi fituar të drejtën me qenë pronë komunale dhe janë vonuar për shkak se buxheti i Kosovës kur u miratua me 15 Mars të këtij viti ka pasur shkurtime buxhetore edhe unë nuk dua për komunat tjera pasi tabelat dhe shifrat i kam edhe i kam këqyrë me shume kujdes dhe ne kemi shkurtime buxhetore, e në këtë rastin konkret ka pasur me fillua sivjet bilum me sakte u deshtë me fillua procedurat ne fund të vitit 2019 mirëpo ata e kanë shtye për vitin e ardhshëm edhe e kanë miratua që projekti i stadiumit i kategorisë 2 i përshtatshëm edhe për ndeshje ndërkombëtare të shtyhet për vitin 2021. Unë mundem me ju sigurua fakte të padiskutueshme që kjo është e vërtete siç e kanë shtyje edhe stadiumin në Ratkoc. Pra përveç që kemi shkurtime buxhetore me 15 Mars vendimi i i fundit i Kuvendit të Kosovës për miratim të ndarjeve buxhetore për këtë vite pasi u vonua buxheti për këtë vite, ne kemi heqje të projekteve, shkurtime të fondeve dhe shtyrje të 2-3 projekteve të cilat nuk e i se kënd e kanë konsultua për me i bo këto veprime por e di që është gabim me ju pamundësuar komunave edhe ne investime kapitale për me ja heq projektet, me ju shkurtua fondet ose me ja shtyje projektet siç ka ndodhur. Mbrojtja nga breshëri- ne e marrim një kompensim 25% fermerët e dëmtuar nga breshëri dhe stuhitë, fondi është ndae dhe komunës se Rahovecit i takojnë në bazë 2,641,000 euro ka qenë vlera totale e dëmit të shkaktuar me 19 dhe 20 Maj të këtij viti dhe neve na takojnë 660,551 euro. Po ashtu po tentojmë me i marr edhe 100,000 euro që kanë të bëjnë me dy raporte që ju kam dërguar më herët Ministrisë së Bujqësisë për dëmet nga erërat e forta dhe dëmet nga ngricat që ishin ne fund të Marsit pra demet nga ngricat dhe dëmet nga erërat e forta, pra këto dy raporte janë 275,000 që 25% i bien afërsisht mbi 90,000 euro dhe nëse vërtet na japin atëherë gjithëpërfshirja pra fermerët dëmshpërblehen 25% dhe jo vetëm të një zonës pasi që me këtë raportin qe kemi fitue të fundit edhe dëmi nga breshëri kryesisht kanë qenë në Hamoc mirëpo dëmet që kanë ndodhur nga erërat e forta sidomos ne serra e që përfshin edhe pjesa tjera të komunës se Rahovecit. Sido qoftë është një lehtësi që megjithatë kemi mbërri me bo një presion pozitiv direkt institucional pasi kemi pasur edhe Ministrinë e Bujqësisë këtu edhe me mbërri me fitua të drejtën për me i kompensua fermerët 25%. Sigurisht se nuk është e mjaftueshme dhe dy mundësi janë që do ishte me i shfrytëzua e që realisht nuk po mundemi me i shfrytëzua rrjeta antibreshëer që janë me standarde neper Evropë dhe plot vende ku janë bujqësore dhe sistemi anti breshër- raketor, që realisht nuk lejohet pasi është problem që i kalon kompetencat e qeverisë se Kosovës ose të institucioneve të Republikës se Kosovës, qe është një problem që ka të bëj me hapësirën ajrore që e kontrollon NATO nëpërmjet hungarezëve dhe ne kemi bërë edhe një përpjekje pasi ju e dini ë unë UNMIK-un nuk e njoh hiq, që komuna jonë në mënyre indirekte që me ndikue,po ashtu edhe nënkryetari Fatmir Iska është dëshmitar që ata me bo presionin tek administratori i Unmik-ut që njësie e OKB-de dhe Unmiku që është në Kosovë me ndikua te këta sipas rezolutës 1244 me KFOR-in apo të të NATO-s që me pas mundësi me bo diçka që Kosovës me ju mundësua sistemi raketor kundër breshër, edhe kjo nuk është vetëm kërkesë e komunës se Rahovecit por e gjithë Kosovës. Pra kemi provua me gjet edhe mekanizma tjerë për me ndikua që me pas mundësi që ndoshta edhe me bo diçka ne sistemin raketor anti breshër, përndryshe ne Serbi ka qene funksional por ka dal prej përdorimit mirëpo kanë dalë disa sisteme te reja që nuk e di sa munden me u aplikua ne Kosovë, sigurisht që

kërkojnë financim pasi është program me vlera të larta investive por Kosova është mirë me pas sistemin për mbrojtjen nga breshëri raketor apo rrjeta antibreshër apo fondi i sigurimeve bujqësorë që marrin pjesë fermerët edhe pastaj paguhen për dëmet që mund të ju shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore edhe ne këtë drejtim ka probleme për shkak se kompanitë e sigurimeve nuk dëshirojnë me marr përsipër me kompensua fermerin nëse dëmtohet nga breshëri sepse është diçka e paparashikueshme edhe ata nuk dëshirojnë me marr përsipër. Riparimet në shkolla – njëri lot është fituar dhe është lidhë kontrata, loti i dytë vazhdon procedura dhe ne ato lote është riparimi i shkollave po ashtu edhe riparimi i shkollës ne Gexhë, edhe oborri i shkollës ne Malësi të Vogël por edhe të gjitha shkollat ku ka nevojë për ndërhyrje në nyje sanitare, ne riparime, ne rrethoja ne të gjitha shkollat ku ka nevojë në komunën tonë. Trotuaret - kërkesat për rruge dhe rrugica janë të mëdha, pra dua të ju them se vetëm rrugën katër korsi qeveria që shkoj ka bërë propozimin ne parlament që brenda ditës 1,100,000 euro të hiqen nga rruga katër korsi pra vetëm në këtë projekt po ashtu edhe dy kode tjera na ka hequr që lidhen me rrugë lokale në qytet dhe fshatra pra i kan larguar pa ndonjë arsye me vendimin e 15 Marsit dhe tash ne grandin e përformances që kemi fituar 255,751 euro u deshtë me ndaje në gjysme ne rrugë lokale dhe ne trajtimin e shtretërve të lumenjve. Pra këtë fond ne kemi mundur me ndaje krejt për diçka tjetër mirëpo u deshtë me ndaje për projektet që i kemi pasur edhe jemi kon të sigurt që kemi mbështetjen e nivelit qendror. Sido qoftë rrugë rrugica edhe trotuarin për të cilën është biseduar në këtë sallë dikur ka me u bo, sigurisht që do bëhen pasi lidhen me procedurat p.sh. çështja e ndërtimit të rrugëve dhe rrugicave është në procedurë dhe shpresoj që shume ka me u lidhë kontrata, nëse nuk do të kemi ndonjë ankesë atëherë ne ato rrugë janë të përfshirë edhe trotuaret e sigurisht edhe trotuari për të cilin po flasim.

**Sali Sallteku** – Faleminderit kryesues, vërtet ishte një referat i gjatë dhe i mirë e sigurisht që e kemi përcjellë gjithë raportin mirëpo për shkak të gjendjes që jemi me maska do ishte mirë të jemi sa me të shkurtë gjate diskutimit. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

**Ali Zhuniqi** – Unë e mbështes kolegun paraprak që tha jo për shkak të temperaturës brenda por për shkak të situatës dhe rrethanave për pandemi gjithashtu edhe ne lidhje me diskutimin e raportit 6- mujor nga kryetari që ka bo, unë mendoj që ka punë të mira që janë bo edhe sigurisht edhe shume punë që kanë nevojë me u kritikua por ne raport me kohen edhe ne lidhje me situatën, ne kemi dashur me përgjysmua sa me shpejt edhe me u shpërnda nga kjo sallë për shkak të situatës. Por një gjë që nuk është në rregull kryetar nga ju pasi brenda fjalimit tuaj që ju thatë, keni rae ne kundërshtim me fjalët e tua dhe ne e dimë se kërkesën për funksionalizimin e repartit të hemodializes ka qenë dhe unë po besoj që keni bërë në formë protokollare kundrejt QKUK-së dhe spitalit regjional dhe kundrejt Ministrisë. Andaj nuk është e drejtë të lëshoheni në polemika karshi kundër Ministrit Vitija për arsye se ka qenë kërkesë e jotja edhe sigurisht ato kërkesa shqyrtohen në Ministrinë e Shëndetësisë andaj si i tillë nuk është mirë në situatën që jemi të lëshoheni në polemika të tilla, pasi do të shihni edhe procesverbalin që rae në kundërshtim me fjalët e tua, ku në njërën anë thënë që ka qenë qellim edhe kërkesë e jona me u funksionalizue ndërsa ne anën tjetër thojshe që nuk u deshtë me u hapë për shkak të pandemisë dhe unë nuk e besoj që duke e njohur edhe personalisht z. Vitija është lëshuar në nivele të tillë si ju e prezantuat, për arsye se edhe ai i njeh mirë rrethanat e pandemisë dhe si e tillë nuk qëndron edhe nuk besoj që keni pasur të drejtë pa dashtë me të sfidua në lidhje me këtë aspekt ose me të qitë ty poshtë por unë mendoj se nuk është e drejtë.

**Kryetari** – Nuk po dua të bëj replikë, ideja është se nuk me keni kuptuar pasi unë kam thënë se ne kemi kërkuar zyrtarisht hapjen e hemodializes por nuk kemi kërkuar asnjëherë që hapja me qenë vetëm në kohë pandemie pra vetëm gjate periudhës se pandemisë me qenë e hapur pra këtë koncept e kemi refuzuar, pra reparti i dializes me u hap mirëpo ne momentin kur të hapet që të mos mbyllet asnjëherë dhe jo me qenë e hapur vetëm në periudhën e pandemisë. Dhe ne këtë kundërshtim e kemi bërë me rrugë ligjore që mos me zbatua atë vendim ose me u ndryshua ai vendim. Pra ne kohe pandemie po si po hemodializa por kur të hapet

që mos të mbyllet anjeherë. Pra ne i kemi trajtuar këto situata në mënyre institucionale. Pra e gjithë lufta jonë ka qenë se jemi për ta hapur repartin e hemiodializes mirëpo jo të funksionoj vetëm gjate kohës se pandemisë dhe koha e pandemisë atëherë nuk është ditur se sa do të zgjasë, sepse ne kemi menduar se do të zgjas vetëm 2-3 muaj por po del se nuk është ashtu.

**Munib Durguti –** Faleminderit shume, edhe unë do të jem shume i shkurtë në lidhje me temën dhe e shoh të arsyeshëm të lidhem sadopak pasi për një kohë të gjatë kam qenë i lidhur me këtë temë. Ajo që tha kryetari edhe qëndron dhe për mua ka qenë shume e habitshme pasi e kam përcjell këtë proces, se si erdhi një vendim i tillë pra një vendim në shpërputhje me punën edhe me vendimet paraprake që i ka sjellë bordi i SHSUK-së. Pra e kemi një vendim për hapje të përhershme d.m.th. vendimi i parë flet për hapje të përhershme të hemodializes dhe i ka marrë për bazë shkaqet, rrethanat, numrin e pacienteve e kështu me radhë. Ky vendim i qeverisë paraprake, shkon edhe me tej ku thotë se hapet për pacientë pozitiv d.m.th. e degradon komplet investimin e komunës, komplet donacionin edhe personelin i cili një pjesë e personelit ka vite që është pranuar këtu pra është krijua këtu stafi dhe sigurisht që kryetari ka bërë mirë që ka pasur qëndrime strikte që mos me lejua me degradua projektin. Pastaj janë ndërrua disa qeveri d.m.th. edhe unë kam qenë prej ithtarëve që qendra me u funksionalizue sa me shpejtë mirëpo me ndërrimin e institucioneve në Kosovë atëherë ndërrojnë edhe prioritete për sa nuk kemi kontunuitet. Prej bordit SHSUK-së,ish drejtorit SHSUK-së i cili ka qenë me qëndrime shume strikte, bilum me disa letra që kemi komunikua, e obligon SHSUK-në që me pajisë qendrën e dializës në Rahovec me një transfuzion dhe pastaj ai dokument harrohet prej drejtorit pasues, edhe ajo u bë problem me vite se nuk hapet qendra sepse nuk ka transfuzion. Drejtori e obligon SHSUK-në me na pajisë me transfuzion edhe kjo disi ai dokument humbet edhe askush nuk e merr asnjë përgjegjësi d.m.th. humbet në borde. Iniciativa e fundit është shume e mirë dhe shume konkrete, unë e kom pae atë kërkese ku kërkohet hapja e përhershme gjithashtu kërkohet që transfuzioni të sigurohet prej dy qendrave spitalore Gjakovë-Prizren dhe kjo mos me qenë problem. Unë kisha një vërejtje tek plotësimi i personelit nuk përmendet emri i inxhinierit të ndjerë Agim Thaqi, ku në atë kërkesë kryesuesi i komisionit për hapje të përhershme drejtori i spitalit nuk e përmend atë pozitë që është pozitë që i takon qendrës se dializës dhe nuk e di a është ndonjë lëshim që është harruar. Po ashtu drejtori është mirë që me qenë në kontakt permanent dhe me kërkua ato 13 vende që i ka ndaje kuvendi i Republikës se Kosovës dhe të vinë komplet ne Rahovec.

**Kryesuesi -** Faleminderit z. Durguti, të nderuar kolegë faleminderit per kontributin,kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. **Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria për Buxhetë dhe Financa për periudhën 6-mujore Janar-Qershor 2020.**

**Afrim Limani –** Përshëndetje për ju kryesues, të nderuar asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Raporti financiar i komunës se Rahovecit është i harmonizuar në mënyre të plotë me departamentin e buxhetit të Financave në kuadër të Ministrisë së Financave, edhe pse e kemi pasur një afat të shkurtër për përgatitjen në mënyre që me datën dhe kohen e caktuar të jetë në duart e juaja. Ky raport përbëhet prej 3 pjesëve: pjesa e të hyrave, pjesa e realizimit të buxhetit apo shpenzimit të buxhetit dhe pjesa e tertë është raporti i zyrës se prokurimit do të thotë të gjitha kontratat të cilat janë lidhur 30 Qershor 2020 janë të inkorporuara në këtë raport. Për dallim prej viteve tjera, për shkak të situatës se pandemisë Covid-19 të hyrat kanë një ramje të dukshme ne raport me vitin e kaluar dhe ne raport me planifikimin. Të hyrat në total janë 404 602 euro dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, e kom fjalën tek të hyrat e rregullta kemi një ndryshim negativ prej 124,622 euro ndërsa ne raport me planifikimin duke përfshirë këtë periudhe 6-mujore atëherë kemi një zvogëlim apo ramje të hyrave me vlerë prej 173,816 euro. Në faqe numër 4 kemi të prezantuar një tabelar, të hyrat e rregullta bashke me gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut, që do të thotë ne total të hyrat e rregullta janë 478,462 euro ndërsa vitin e kaluar kemi 612,672 euro që i bien një ndryshim negativ në total 134,210 euro. Në faqe numër 5,kemi të prezantuara të hyrat sipas kategorive ekonomike dhe

nëse i referohemi shtyllës se katërt e shohim se gati ne çdo kategori ekonomike dhe ne çdo lloje takse ka një zvogëlim pra një diferencë negative ne raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar me përjashtim të taksa për legalizimin e objekteve që është një ndryshim pozitiv që ka filluar për herë te parë se aplikuari dhe e falënderojmë Fehon që na ka ndihmuar ne planifikim në të hyra. Për kundër situatës ne kemi arrit që punëtorët tanë të dalin në terrenë edhe kanë bërë verifikimin e objekteve dhe e dimë ne që është një kriter bazë për definimin e pasqyrave financiare, nëse nuk bëhet verifikimi të paktën e 1/5 apo në shifër të na bien diku 2400 objekteve atëherë automatikisht pasqyrat financiare marrin një opinion negativ dhe ne deri në këtë periudhë kemi arrite që të paktën ti verifikojmë deri ne 969 objekte. Në faqe numër 7, kemi shpenzimin e buxhetit në total sipas kategorive ekonomik dhe në kuadër të programeve. Shpenzimi i buxhetit deri ne këtë periudhë është në masën prej 6,639,965 euro apo shprehur në përqindje është 45.06% dhe ajo çka e karakterizon këtë është se investimet kapitale kanë një rritje të shpenzimit të buxhetit në përqindje prej 56.98%. Në faqe 9-13 kemi të prezantuar në raport shpenzimin e buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve dhe sipas kategorive ekonomike dhe ne faqe 12 e kemi në total një rekapitullim të këtyre shpenzimeve dhe ajo qfarë deshta me than se ne këtë periudhë 6-mujore shpenzimi i buxhetit është ne raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është dukshëm me i madhe sepse ne si drejtorie financave apo si komunë kemi dhënë prioritet të gjitha obligimeve apo të gjitha faturave që kanë qenë të paraqitura i kemi ekzekutua dhe i kemi bërë pagesën e tyre duke marrë parasysh edhe situatën ne te cilën jemi gjendur sepse operatorët kanë pasur nevojë mjete financiare. N e faqe 13 kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit sipas komunalive ndërsa krejt ne fund e kemi raportin e zyrës se prokurimit, të gjitha kontratat që janë lidhur deri me 30 qershor ku vlera e lidhjes se kontratave është 784,486 euro.

**Kryesuesi -** Faleminderit shume drejtor për prezantimin dhe paraqitjen e raportit 6 mujorë të drejtorisë për Buxhete dhe Financa. Të nderuar kolegë kuvendarë, ne e kemi shqyrtuar edhe trajtuar edhe ne komitetin për Politikë dhe Financa, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike pasi nuk po shoh që dikush dëshiron me shtua diçka rreth kësaj.

**Sali Sallteku –** Unë e pash që edhe drejtori ishte shume i qartë edhe ne përmbajtje e kemi përcjellë. Unë kam një propozim nëse edhe ju dakordoheni edhe ju të gjithë . Unë besoj që për dy orë mundemi me krye krejt dhe nëse pajtoheni kisha thënë që me vazhdua edhe me përfundua pasi vërtet është nxehtë i madh edhe jemi në një situatë të tillë pandemike.

**Kryesuesi –** Faleminderit shume z. Sallteku, vërtet ne e kemi diskutuar të gjitha edhe ne komitetin për Politike dhe Financa por kemi rendin e ditë[s pak me te ngarkuar edhe sigurisht që varet krejt nga ne se sa të zgjatemi dhe nëse ju pajtoheni e kishim vazhduar edhe e kishim përfunduar. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës se paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë.**

**Afrim Oruqi –** Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtorë kolegë, të nderuar anëtare të KPF-së. Para juve keni vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kërkesë të Kryetarit të fshatit Çifllak. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Çifllak për parcelë P-00169 dhe kjo parcelë është ne emër të pronës shtetërore të Kosovës, behet fjalë për 35 ari 41m2. Këshilli i fshatit ka kërkua prej kësaj sipërfaqe ne marrë në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vite ne sipërfaqe prej 250 m2. Qëllimi i kësaj sipërfaqe në shfrytëzim është në interes të përgjithshëm dhe këshilli i fshatit Çifllak për qëllime me ndërtua një objekt i cili do të shërbej komunitetit aty. Afati kohor është për 99 vite dhe prona jepet në shfrytëzim pa kompensim, pa të drejtë të kalimit të pronarit pra toka mbetet prapë në pronë shtetërore KK. Rahovec. Pas aprovimit të vendimit të kryetarit, do të bëj një kontratë të veçantë ku nuk do të tjetërsohet pronari. Ftoj anëtarët e Kuvendit që pas shqyrtimit të aprovojnë vendimin për dhënin në shfrytëzim afatgjatë të pronës në zonë kadastrale në Çifllak.

**Kryesuesi** –Faleminderit drejtor, e thash edhe edhe me herët se e kemi trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomandua edhe Kuvendit për aprovim. Atëherë nëse nuk ka diçka rreth kësaj pike, e qesim në votim pikëm e pestë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të komunës për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike komunale P - 04381-0**

**Afrim Oruqi** – Bëhet fjalë për këmbim të pronës ndërmjet parcelës shtetërore të Kosovës KK.Rahovec P – 04381-0 pronë shtetërore e Kosovës ku kësaj parcele të i merret sipërfaqja prej 126 m2 dhe të i bashkëngjitet parcelës private në emër të Asllan Çantës nga Rahoveci ndërsa parcelës me pronar Asllan Çanta nga Rahoveci të i merret sipërfaqja e njëjtë prej 126 m2. Qëllimi i këtij këmbimi është se këto parcela pra kjo parcelë private dhe parcelat tjera përreth kësaj parcele nuk kanë rrugë publike dhe çasje, pasi janë të bllokuara disa prej këtyre parcelave dhe kjo parcelë private kufizohet me një parcelë shtetërore e cila tash e shume vite shfrytëzohet dhe është rrugë e kalueshme pasi pronarët përreth saj veç e kalojnë. Mirëpo sipas kërkesës dhe qëllimi jonë është që me këmbye edhe me rregullua këtë hapësirë atje edhe me bo rrugë publike d.m.th. me përpjesëtua ne mënyre të barabarte pra aq sa i merret edhe të i jepet. Secili prej jush e keni një raport të një komisioni i cili është themeluar për ta vlerësuar pronën që japim dhe që marrim pasi është kategori e pronës se njëjtë pra zonës kadastrale të njëjtë. Qëllimi është hapja e rrugës dhe dalja e pronave private në rrugë publike. Ftojë kuvendaret që pas shqyrtimit të aprovojnë propozimin e vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private.

**Fehmi Cena** – Mendoj që kur është në pyetje kërkesa për këmbimin e pronës publike me atë private, komuna duhet të jet syhapur që vërtet me ju dal në ndihmë rastit të qytetarit për atë që kërkon kur është interesi i tij por në anën tjetër gjithmonë duhet të ketë parasysh që të mos dëmtohet parcela që është pronë shtetërore apo nëse ka mundësi në te njëjtën kohë të kryhet edhe ndonjë veprim tjetër në shërbim të qytetareve të tjerë që kanë pronat e tyre private. Drejtori e tha që ky rirregullim i mëgjeve ka të bëj me tepër me përhapjen e rrugës por vetëm për një parcelë private ndërsa e ceku se disa parcela tjera private aty nuk kanë rrugë. Tash në një të ardhme të afërt edhe ata mund të kërkojnë diçka të ndryshojnë aty për interesa të tyre. Është e vërtete se paska dal ai komisioni dhe ne i besojmë atij komisioni që ka dal ne terrenë me bo vlerësimin mirëpo unë mendoj që komisioni edhe ne këtë rast edhe ne raste tjera duhet të ketë parasysh kur del në terrenë për një parcelë për një veprim, ndoshta me një veprim mund të kryhen edhe veprime tjera që me i zgjedh çështjet edhe të palëve të tjerë sepse edhe ata mund të kërkojnë të njëjtën gjë. Pra nëse është në pyetje rruga atëherë është deshta ndoshta me u angazhua për të gjitha ato parcela që me u zgjedh me një lëvizje me një veprim edhe çështja e tyre. Natyrisht duhet të kihet parasysh gjithmonë që prona shtetërore të mos dëmtohet ose le të dëmtohet pak por në të jetë në interesin e shumicës e jo vetëm të njërës palë.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, shumicën çka deshta me than veçse e tha edhe z. Fehmi Cena pasi ky ka qenë problem i madhe edhe me herët pasi edhe ne jemi përball me këto probleme, sinqerisht është mirë që ka dal edhe ky propozim pasi kishte mundur me ardh edhe deri te ndonjë mosmarrëveshje, edhe sigurisht edhe pajtohem me diskutimin e doktorit. Njëherë deshta me tërheq fjalën por vetëm edhe këtë e thash.

**Sali Sallteku** – Unë kam qenë në atë vend me herët edhe bisedova me Munibin sigurisht se do të uleshin tensionet dhe konsideroj se duhet me krye sepse ja vlenë sa me parë me zgjidhë atë çështje pasi ka shume vite si procedur dhe do ishte mirë te i jepet zgjidhje.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Sallteku, atëherë të nderuar kuvendarë e qesim në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës se paluajtshme personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatshkurtër.**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, para jush keni vendimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, që bëhet fjalë për gjashtë (6) parcela ku 3 parcela janë në zonën kadastrale ne Rahovec, 1 parcelë në Bërnjak,1 parcelë në Fortesë dhe 1 parcelë në zonën kadastrale në Xerxe. Qëllimi është dhënia në shfrytëzim afatgjatë prej 15 viteve, prona e paluajtshme janë të gjitha pronë shtetërore të Kosovës KK. Rahovec. Pra bëhet fjalë për parcelën P-07998-0 me një sipërfaqe prej 25 ari e 77m2 në Rahovec. Bëhet fjalë për parcelën P-04475-0 me sipërfaqe 30 ari 93m2 në zonën kadastrale ne Rahovec, bëhet fjale për parcelë kadastrale në Bërnjak P-36-0 me një sipërfaqe prej 39 ari 12m2, bëhet fjalë për parcelën P-0438-1 me sipërfaqe prej 12 ari 8m2 në zonën kadasrlae në Rahovec, bëhet fjalë për parcelën në zonën kadastrale në Bellacerkë P – 101833-0 me sipërfaqe prej 26 ari 15m2 dhe bëhet fjalë për parcelën P – 02164K-7 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 hektar 37 ari e 0,7m2.Qellimi është dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave, të gjitha janë publike, përveç kësaj është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave është 15 vite. Propozimi është Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën që gjithmonë kur të sheh të arsyeshme që të ndërpres kontratën dhe nëse ka ndonjë planë tjetër që është në interes me te veçantë dhe të përgjithshëm përveç kësaj. Procedurat e këtij pas aprovimit të vendimit do të shkojnë të gjitha këto prona në ankande publik, ku qytetarët kanë të drejtë aplikimi për me i marrë në shfrytëzim me qira dhe çmimi do të caktohet sipas rregullores për takse dhe tarifa komunale. Ftojë kuvendarët që të votojnë propozim vendimin për dhënien e pronave me qira.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, tash e kemi propozim vendimin përpara por unë mendoj dhe kisha propozua që këto 6 parcela me i ndaje në 6 vendime ashtu siç kemi vepruar deri me tani d.m.th. përfshirja e këtyre 6 parcelave me një vendim nuk me duket e arsyeshme. E di që ka me shkua ne ankand edhe ofertuesit kanë me pas zgjedhje me shume mirëpo kur kemi të bëjmë me prona duhet të jemi pak me te kujdesshëm edhe me shkua hap pas hapi ashtu siç kemi vepruar deri me tani.

**Masar Popaj** – Unë deshta të ndalem te parcela kadastrale sipas certifikatës se pronës 1833K me sipërfaqe të përgjithshme prej 2615m2 në kulturë arë e klasës se tretë, zona kadastrale në Bellacerk në vendin e quajtur T13 të evidentuar pasuri shtetërore. A banë me ditë se ku është saktësisht kjo pronë në Fortesë.

**Fehmi Hoxha** – Më herët me kujtohet para disa seancave, a ka ekzistuar ndonjë kërkesë që sigurisht edhe kanë të drejtë me bo kërkesë edhe qytetarët, të fillojnë procedurat e gjithsesi që zhvillohet procedurat përmes ankandit i jepet mirëpo këtu duhet me pas një arsyeshmëri, që sigurisht me ruajte pronën. Mirëpo duhet me dit se kush po dëshiron me marr atë pronë, a po dëshirojmë me ja dhënë dikujt apo si po duam me veprua. Unë them se duhet te jepet një arsyetim siç e tha edhe z. Durguti që tash i kemi 6 parcela me një vendim që nuk janë në të njëjtin vend. Pra duhet një arsyetim me te mirë dhe të duhur prej drejtorit po kërkoj se çfarë është kjo.

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, sa i përket pyetjes se parë, këto 6 parcela janë të ndara pra janë zona kadastrale. Ne i kemi qitë për shkak të ekonomizimit të kohës me një vendim pasi këto parcela kanë me shkua veç e veç ne ankand publik dhe për këto parcela kanë[ me pas të drejt me aplikua me shume se një person d.m.th. nuk kanë me shkua ne bllokë. Pra kanë me u dhanë, kanë aplikua dhe kanë kërkua me shume se një person këto parcela, qëllimi është se në një prej seancave të kaluara të kishim qitë veç e veç atëherë do të kishim sot plus edhe 6 pika tjera të rendit të ditës pra kjo ka qenë ideja. Dhe nëse ju vendosni atëherë herën tjetër ne mundemi me i qitë veç e veç d.m.th. kjo është ideja pasi që këto janë të ndara dhe ne ankand publik kanë me shkue veç e veç pasi kanë me u bo 6 kontrata dhe kanë me përfitua 6 aplikues sigurisht kush jep me shume sipas ankandit publik. Në bazë të pyetjes se ku gjendet kjo parcelë, ju them se zona kadastrale në Fortesë është e madhe dhe duhet me pas gjeodet këtu dhe me pas gjeoportal e saktësisht me specifikua se ku gjendet saktësisht kjo. Unë mundem me informua kuvendarin nëpërmjet emalit dhe me ja precizua ndonjë

objekt afër që e ka me shkrim dhe një ortofoto saktësisht se ku gjendet. Dhe arsyeja se pse po jepen me qira sepse përveç tjerave shumica e këtyre pronave janë prona të komunës pra prona shtetërore të Kosovës edhe ashtu po përdoren edhe po shfrytëzohen edhe ne nuk kemi mundësi me inkasua mjete materiale. Qëllimi përveç që është i paraparë me këtë vendim me pikë , që është me i ruajte e me i mbrojte e me i pamundësue njerëzve me u thirre pash shfrytëzimit mbi 1- apo 20 vite dhe nëpërmjet avokateve me bo padi që me fitua të drejtën e pronësisë atëherë ne përveç që dojmë me i ruajte këto me i mbrojte me i dhanë me qira dhe sigurisht që me përfitua nga këto edhe me i kthye në investim kapital në rrugë, në ndriçim dhe punë tjera. Pra kjo është ideja.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, edhe unë pajtohem plotësisht me kolegët që diskutuan paraprakisht. Ne këtu marrim vendim për me i dhanë këto prona për shfrytëzim përmes ankandit gjithsesi, por vendimi të jetë i qartë që secila pronë me u dhanë me vendim të veçantë. Nuk është problem që i keni sjellë kështu mirëpo për mos me shtyje për mbledhjen e radhës, si kuvend ne marrim qëndrim që secila ta ketë ankandin e veçantë për secilën pronë të jetë e veçante, kjo është e para. Pastaj qëllimi çdo herë thuhet kështu edhe për të gjitha qeverisjet që kemi kalua që të behet ruajtja e pronës, siç u drejtua një pyetje nga kolegët se kush po i merr këto prona. E sigurisht po i marrin matrapazët që sigurisht po e gjejnë rrugën dhe mënyrën si me i përvetësua, kështu që unë jam për atë që me i ruajte dhe është mirë me i ruajte. Ne e dimë shumë mirë se komuna e Rahovecit se sa hektarë i ka pasur dhe tani nuk e di edhe sa i ka tash sepse neper rrugë të ndryshme që i dinë ata vet edhe i kanë kalua ato dhe ne bashkëpunim me te tjerët dhe tash kemi shume pak prona komunale. Pra unë jam për ruajtjen e pronës por deshta një pyetje konkrete me bo tek 2.6, në Komitetin për Politike dhe Financa që e kemi shqyrtua pasi këtu ka qenë edhe një kërkesë e një zotëri që ka qenë me sa kujtohem Samedin Isa Krasniqi nga Rogova dhe ai ka bo kërkesën për me kultivua pula shtëpiake por jo fermë pra me krijue si oborr për rritjen e pula shtëpiake me sipërfaqe 2817m2 kështu e kemi pasur në KPF, po e potencoj nëse nuk jam gabim kërkesa e tij. Është mirë me na tregua drejtori se nëse ai ka kërkuar këtë sipërfaqe prej 2817m2 atëherë si ruhet kjo sipërfaqja 13,707m2, pra është në pyetje krejt kjo sipërfaqe apo vetëm 2817m2 pra po kërkojë sqarime nga drejtori.

**Sali Sallteku** – Është e vërtetë se kjo u sqarua nga ana e drejtorit edhe u bë mirë që secila të sjellët veç e veç. Edhe unë po dua të di se ku gjendet kjo pronë në Xerxe, pasi në pronat në Çfllak dhe Rahovec ishin të qarta edhe sigurisht që kjo punë u deshtë të kryhet sa me parë. Mirëpo këtu pak po ka hapsirë për dyshime edhe në Xerxe është mirë me ditë dhe me lanë për mbledhjen tjetër që me pas mundësi me i qitë veç e veç edhe me u konsultua edhe me ditë se ku gjenden. Pra unë kështu kisha propozua sepse nuk po dimë se ku gjenden e posaçërisht në Xerxe nëse është ai vend atëherë është një problem që vazhdimisht është kërkuar në të gjitha kohët kështu që me mirë duhet të lëmë veç e veç edhe te kemi mundësi të shqyrtojmë në mënyrë të detaizuar. Pra unë jam që kjo të mbetet për mbledhjen tjetër e sigurisht nëse pajtohen të gjithë dhe të sjellën veç e veç edhe të shohim grafikisht në detaje se si është puna e tyre.

**Kryesuesi** - Faleminderit z. Sallteku, atëherë meqë vendimet duhet të merren veç e veç për secilën parcelë, ndoshta edhe unë jam i mendimit që nëse ju pajtoheni që te kemi për mbledhjen e ardhshme por duhet llogaritur se do të kemi edhe 6 pika tjera shtesë ne mesin edhe pikave tjera që kanë me qenë aty edhe ato me plan të kuvendit komunal.

**Fehmi Hoxha** – Sigurisht edhe 6 pika tjera por tani i kemi edhe jemi duke marrë vendimin që të miratohet shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit që ishte në Çifllak, këtë tjetrën e kryem kurse tash 6 po i bëjmë lëmsh në Rahovec. Pak ka rëndësi në seancën e radhës pasi kjo nuk është urgjente që duhet me na ardhë 6 pika. Ju mundeni me i qitë 2 prej këtyre 6 pikave e pastaj të vazhdohet ne seanca tjera, pasi nuk është shume urgjente. Kështu që unë pajtohem me z. Sali Salltekun edhe ne aspektin juridik që tha me herët z. Durguti, kërkoj që për seancën e radhës pasi është pronë publike pronë komunale që vendos kuvendi komunal për

hapësirat publike dhe pronat komunale është neni vendimmarrës. Pra ju duhet të përgatiteni mirë edhe nuk ka nevojë me i qitë menjëherë të gjashtat por cilat janë me prioritetet që sigurisht ekzekutivi i qetë në bazë të kërkesave që bëhen edhe synimeve mirëpo ju mos i qitni 6 por për mbledhje ne radhës qitni 2 pasi ne kemi ende seancat e radhës kështu që mos i bëni tollovi.

**Fatmir Iska** – Unë po pajtohem pasi edhe ne fillim me kujtohet shume mirë prej grupit parlamentar të PDK-së e di që për çdo pikë kanë kërkuar me qitë veç e veç në rendin e ditës e që edhe unë jam i pajtimit për këtë. Po ashtu jam i pajtimit për këtë pasi nuk kemi urgjenca shume të mëdha këtu mirëpo drejtori e ka pae të arsyeshme në bazë të kërkesave që janë drejtua edhe pe rate arsye edhe janë qitë të gjitha pra 6 parcelat. Unë jam i pajtimit edhe dakordohem plotësisht me juve që këtë pikë të rendit të ditës me shtyje për seancën tjetër edhe ndoshta jo të gjitha me i qitë ne rend dite. Por për gjithë këtë drejtori u bazua në bazë të kërkesave që kanë palët dhe ne do të shikojmë edhe rendin e ditës se nëse është i ngarkuar shumë atëherë do të qesim 2 apo 3 e pastaj ne seancën tjetër kështu me radhë do të vazhdojmë në mënyrë që të ruhet ky interes publik.

**Kryesuesi** – Faleminderit nënkryetar, ne sa po e shoh ishin edhe propozimet e kolegëve që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Atëherë duhet të qesim në votim për mbledhjen e ardhshme. Konstatoj se pika e shtatë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjet e ardhshme të kuvendit të Komunës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

**8. Shqyrtimi Raportit nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2019/2020.**

**Avni Morina** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Do të jem i shkurtër sa i përket raportit. Atëherë nëse e keni lexuar raportin, vetëm pres pyetje nga ju dhe unë do të mbaj shënime dhe do të përgjigjem. Pra janë të pasqyruara të gjitha aktivitetet që i kemi pasur brenda kësaj periudhe. Faleminderit

**Sali Sallteku** – Faleminderit shumë. pasi i përkas edhe kësaj fushe unë do jem shumë i shkurtër. E dimë shume mirë se në çfarë kushte kemi punuar dhe unë për veti kom shpreh respekt shume të madhe se si e kanë krye deri tash mësimdhënësit me mësimin online që ka qenë, që vërtet ka qenë një punë shume e madhe dhe shpresoj të fillohet edhe neper shkolla por sidoqoftë unë kam pae një angazhim edhe punë që vërtet kanë kërkuar që kjo punë të vazhdohet në këtë mënyrë dhe jo tjetër pasi rrezikohet edhe mësimdhënësi e sigurisht edhe fëmijët. Unë konsideroj se kjo ka qenë një punë e mirë dhe e mbarë dhe shpresoj që hiqet sa me shpejt Korona virusi dhe të kemi suksese me të mëdha.

**Rasim Fazliu** – Unë e pata një pyetje për drejtorin, ku këtu thuhet që 95 studentë janë përfitues të bursës dhe vetëm deshta me pyet se a i keni ndaje bursat dhe kur do të i ndani saktësisht.

**Fatmir Iska** – Unë do të jap përgjigjen për drejtorin, ne vitin e kaluar i kemi ndaje bursat dhe tani e kemi shpallë konkursin, ka përfunduar afati, e kemi formua komisionin dhe tash komisioni ka me krye punën e vet por shpresoj se do të rrisim numrin e përfituesve bursist për këtë vite.

**Kryesuesi** – Faleminderit për informatën, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

**9. Shqyrtimi i Informatës nga DSHPS-ja për periudhën 6-mujore Janar – Qershor 2020.**

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë. Informatën e keni me shkrim dhe vetëm desha të ju njoftojë që në Komunën e Rahovecit janë gjithsej 117 raste me Covid-19, ku 20 raste janë aktive, 79 të shëruar dhe 18 raste me fatalitet.

**Fehmi Cena** – E falënderoj drejtorin e shëndetësisë për këtë informatë, Siç e potencoj se ishte mjaft e shkurtër dhe unë e shoh se vërtet është shkurtër ndoshta është deshtë pak me gjerësisht të jetë informata rreth punëve që janë krye dhe po kryhen në institucionet shëndetësore sepse vërtet mendoj se është duke u bërë një punë e mirë dhe mjaft e madhe atje. Drejtori është përqendruar tek pandemia Covid-19 dhe gjërat janë të qarta, siç e diskutuam edhe ne raportin e Kryetarit që shumicën e gjërave u thanë dhe nuk dëshirojmë me i përsërit këtu. Unë e kam thënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa edhe sot e them që në këtë informatë ndoshta është deshtë me u prezantua edhe një pjesë e punës se stafit shëndetësore për punën që po e bëjnë në këtë kohë edhe rrezikun e madhe që po e marrim përsipër. Po ashtu mos të harrojmë se punëtorët shëndetësor janë duke punuar me kapacitet të plotë me orar të plotë pastaj nuk kemi të drejtë edhe për pushimin

shëndetësorë me shfrytëzua dhe duhet të ceket pasi kjo informatë faktikisht është edhe një formë si gjysme raporti tani. Pastaj tek pjesa sociale që është, karantinimi i viktimave të dhunës në familje ku thuhet se ka pasur dy raste të dhunës gjate kësaj periudhe që ceket aty dhe po ashtu me intereson është edhe strehimorja regjionale që ne e kemi përmend më herët diku në Gjakovë ku gjithashtu i shërben edhe qytetareve të dhunës familjare edhe për komunën tonë, nuk e di a është duke funksionuar ajo për arsye se këto dy raste i kanë dërguar në qendrën studentore ne karantinim pra nuk përmendet strehimorja regjionale, pra kjo është pyetja.

**Rasim Fazliu** – Unë deshta të lidhem me punë konkrete praktike këtu dhe është mirë që kjo drejtori me qenë më vëmendshme rreth Covid-19 kur bëhet fjalë tani sepse kjo salla e Kuvendit administrohet ndoshta prej vet komunës këtu pasi është drejtoresha e administratës por kemi raste kur kemi pasur 3 takime brenda ditës edhe salla sipas informatave ka qenë e dezinfektuar vetëm takimin e parë në mëngjes kurse takimet tjera janë mbajtur pa u dezinfektuar salla, kështu që është mirë me ruajt shëndetin tonë ne rend të parë edhe mos me u përsërit këto gjëra pasi sa me te kujdesshëm që jemi do të ishte më mirë. Po ashtu një gabim gjuhësor e kemi në faqen e dytë drejto, mbi listën e objekteve të dezinfektuar në komunën e Rahovecit, ku shkruan se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo javë, QKMF-ja dhe kujdestaritë dezinfektohen dy herë në javë.

**Sali Sallteku** – Unë e falënderoj drejtorin për raportin që ka bërë dhe vërtet janë shume raste në komunën e Rahovecit 117 raste, po ashtu tash kemi pasur një rast edhe e kisha pyet drejtorin ku një punëtorë i joni që ka vdekur para 3-4 dite që vërtet ka qenë një punëtorë dhe familjar i mirë, a ka qenë me Corona virus apo jo dhe a i merrni ju ato shërbime nëse ka mundësi me ditë, po ashtu edhe atë që tha doktori qe po bëhet një punë e madhe nga punëtorët shëndetësor por nuk paguhen për shërbimin e kryer.

**Fatmir Iska** – Për raportin edhe gjendjen pandemike, pasi këto shifra ndryshojnë pothuajse çdo ditë por fatmirësisht në komunën tonë ka pak të prekur e sigurisht që ne kemi dëshirë që hiq mos me pas asnjë rast por ja që këto ndodhin. Drejtori i prezantoj shifrat prej raportit nga dita e djeshme nga Institutit kombëtar të shëndetit publik pra këto janë shifra të raportit të datës 28.07.2020. Tek dezinfektimi i sallës se kuvendit, e keni të drejtë dhe me vend z. Fazliu, jo vetëm që duhet që sa here të mbahet seanca por edhe KPF-ja duhet të jetë e dezinfektuar dhe kërkoj prej drejtorit që sa herë të ka seanca por me kërkesë të Kryesuesit që kjo të kryhet. Tek strehimorja janë strehuar pasi jam vet dëshmitar që kam nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Komunës OSBE-së dhe Strehimores ne Gjakovë, ku komuna e ndihmon strehimoren me një shume të mjeteve ndersa per rastet të cilët janë të vetizoluar ku doktori besoj që e din pasi drejtoria e shëndetësisë e ka një ekip kujdestar të stafit shëndetësorë ku ata që janë të vetizoluar kontaktohen për çdo nevojë që kanë. Për informacione tjera që ka diçka mundet me shtua drejtori.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë të nderuar kolegë kuvendarë, kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

**10. Shqyrtimii Informatës mbi implementimin e Planit për investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit.**

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë. Plani për investime në hapësirat publike e kemi nga viti 2016-2021, një plan që praktikisht komuna e Rahovecit e implementon dhe në baze të atij planit e bëjmë mirëmbajtjen e hapësirave publike. Mirëpo një dallim është prej vitit të kaluar që kam raportuar në Kuvend është rritur vlera dikun prej 14,000 euro, pasi varrezat civile në çdo vendbanim është shtuar për shkak se gjate vitit bëhet prerja e vegjetacionit 3 herë e jo 2 herë siç ka qenë në vitet e kaluara. Pastaj dallimi është se janë futur edhe objektet institucionale siç AMF-të edhe zyrat e gjendjes civile në gjithë komunën e Rahovecit d.m.th. ky ka qenë dallimi që është rritur vlera e kësaj prej vitit të kaluar në të cilën është raportuar. Unë tani nuk po dua me shtua diçka për shkak se e keni raportin para jush dhe nëse dikujt i intereson diçka me tepër me dit rreth kësaj do të jemi këtu dhe do të jap përgjigje të gjithëve. Faleminderit

**Rasim Fazliu** – Unë kam një pyetje edhe pse duket si pak ne formë të humorit, sa fshatra i ka komuna e Rahovecit, kjo pyetje shkon për drejtorin.

**Përparim Krasniqi** – Komuna e Rahovecit i ka 35 fshatra dhe një qendër urbane. Të gjitha janë të evidentuara në bazë të regjistrimit të popullsisë që po ashtu i kemi zyrtare.

**Kryesuesi -** Të nderuar kolegë kuvendarë, meqë nuk ka të tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

**11. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.**

**Artan Asllani –** Përshëndetje për të gjithë, unë nuk dua të lëshohem në detaje rreth kësaj informate, për shkak se keni informatën për zonën ekonomike dhe ajo që dua të them rreth kësaj pike është se ne jemi duke bërë përpjekje të mëdha të thithim investime sa me te mëdha në këtë hapësirë. Nëse keni ndonjë pyetje, unë jam këtu për të ju përgjigjur.

**Kryesuesi –** Të nderuar kolegë kuvendarë, faleminderit shume të gjithëve për kontributin dhe mirë u pafshim në mbledhjen e radhës.

**Mbledhja përfundoj 13.00**

**01 Nr. __________/20**
**Rahovec, 27.08.2020**

**Procesmbajtësi:**

______________
**Agim Hoti**

**K R Y E S U E S I**

______________
**Afrim Dina**

# Komuna Rahovec

## Opština Orahovac/Municipality of Rahovec

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | |
| Për/Za/To: | **z.Afrim Dina –Kryesues i kuvendit** |
| Përmes/Preko/Throught: | **z.Afrim Limani-Drejtor për Buxhet dhe Financa** |
| Subjekti/Predmet/Subject: | **Propozim** |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot / Br. prot. 2980 Më / Dt. 19.08.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Të nderuar,**

Sipas Ligji Nr.07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 07/L-001 ,mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së kosovës për vitin 2020 me Nr.2/07 Gusht 2020 po ju dorëzojmë propozimin për shpërndarjen e Rezervave të buxhetit komunal në kategorinë e Investimeve Kapitale

**Shuma për shpërndarje është: 993,844,00 euro**

**1.**Në programin Shërbimet Publike (180),nën programi Infrastruktura Publike(18171),kodi funksional (0451).

1. Ndërtimi i rrugëve ne komunën e Rahovecit , kodi **40817** shuma **93,825 €.**
2. Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve,kodi **40809** shuma **33.574 €.**
3. Ndriçimi publik dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues ,kodi **40814** shumë **20,000 €.**
4. Ndertimi trotuareve ne Komunen e Rahovecit(vazhdim), kodi **40818** shuma **20,000 €.**
5. Ndertimi i rrugës Rahovec-Pataqan i Poshtem,kodi **43468** shuma **30,000 €.**
6. Furnizim me gypa , kodi 48189 shuma **9,000 €.**
7. Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale(gropa septike), kodi **49862** shuma **95,000 €.**
8. Krijimi i parkingjeve te reja ne qytet, kodi **48045** shuma **6,000 €.**
9. Përmirësimi i kanalizimeve ne Pastasel dhe vendbanimeve tjera ne Komunën e Rahovecit, kodi **48032** shuma **95,000 €.**

**2.**Në programin Bujqësia,Pylltaria dhe Zhvillimi rural (470),nën programi Administrata (47011),kodi funksional (0421) .

1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore , kodi **40822** shuma **40,000 €.**

2.Kanali i kullimit te tokave bujqësore ne fshatin Ratkoc,Malesi,Gexhe, kodi **89742** shuma **50,000 €**

**3.**Në programin Planifikimi urban dhe mjedis,(660),nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360),kodi funksional (0620).

1. Hartimi i projeketeve te ndryshme, kodi **40839** në shumë **30,000 €**

2.Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe prockave ne komunën e Rahovecit, kodi **40840** në shumë **100,000 €**

3.Krijimi i i hapsirave te gjelbëruara dhe drunj dekorativë, kodi **47914** shuma **17,000 €**

4.Renovimi i ndërtesave publike fasadimi, kodi **43492** shuma **10.000 €**

**5.**Në programin e Kulturë, Rini dhe Sport (850),nën programi Shërbimet Kulturore (85011) ,kodi funksional (0820).

1.Rregullimi i tereneve sportive, kodi **40859** shuma **17,000 €.**

2.Riparimi i shtëpisë se kulturës ne Ratkoc, kodi **41974** shuma **30,000 €.**

**6.**Në programin Arsim dhe Shkencë (920),nën programin Administrata (92055),kodi funksional (0980).

1.Ndërtimi i çerdhes së në fshatin Ratkoc,kodi **45787** shuma **40,000 €.**

2.Ndertimi i shkollës Hoqe e Vogel-Brestoc,kodi **46517** shuma **75,000 €**

3.Ndertimi i shkollës fillore ne Fortese, kodi **48090** shuma **90.000**

4.Ndertimi i çerdhes në Krushe te Madhe, kodi **48202** shuma **25,000 €**

5.Ngrohja qendrore për shkollat e komunës së Rahovecit, kodi **48235** në shumë prej **20,000 €**

**7.**Në programin Zhvillim Ekonomik (480),nën programin Planifikim dhe Zhvillimi Ekonomik (48011),kodi funksional (0411).

1.Ndertimi i shtëpisë se pleqeve, kodi **48051** në shumë **17,445 €**

2.Investime ne turizëm dhe shtigjet e ecjes, kodi **48159** shuma **5,000 €**

**8.**Në programin e Shëndetësia dhe mirëqenie sociale (730),nën programi Shërbimet e shëndetësisë primar (73700) ,kodi funksional (0721).

1.Ndertimi i qendrës Kryesore te Mjekësisë Familjare-Emergjenca, kodi **45693** shuma **25.000 €**

**Ju faleminderit**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT

## PËR VITIN 2019

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqëse e ekipit *Sabile Musa* dhe Anëtare të ekipit *Aida Podrimaj* dhe *Besa Morina,* nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
http://zka-rks.org

# TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme ....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit ....5

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore ....6

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli ....8

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve ....25

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja ....33

Shtojca II: Letër konfirmimi ....35

# Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Rahovecit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimit është fokusuar në:




**Konkluzionet**

**<u>Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore -</u>** Disa pozicione në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin korigjuar pas sygjerimeve tona. Megjithatë, Pasqyrat Financiare Vjetore ishin në përputhje të plotë me rregullat dhe me Standardet e zbatueshme, me përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive të ndryshme ekonomike. Kjo është shpjeguar në detaje tek Paragrafi për Theksimin e çështjes.

**<u>Konkluzioni për MFK -</u>** Menaxhmenti i Komunës ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, dhe me qëllim të permirësimit të performancës në përgjithësi. Megjithatë, ende ka nevojë të përmirësohet organizimi dhe komunikimi i strukturave brenda Komunës, e cila do të ndikonte në raportim dhe bashkëpunim më të mirë në mes të njësive organizative.

**<u>Konkluzioni në lidhje me rekomandimet e mëhershme -</u>** Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2019 ka arritur progres të theksuar duke marrë parasysh që disa rekomandime janë zbatuar dhe pjesa me madhe e tyre janë në proces të zbatimit.

**Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]**

**Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes**

Më gjerësisht shih Pjesën 1 të këtij Raporti.

**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

# Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Rahovecit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Komunës së Rahovecit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

**Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes**

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

**Theksimi i çështjes**

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet në vlerë prej 225,373€ ishin paguar dhe regjistruar në kategori joadekuate. Pagesat në vlerë 105,373€ janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/të përmbarimit. Pjesa tjetër prej 120.000€ ishin buxhetuar gabimisht. Komuna ka dhënë shpjegime në PFV tek shënimet shpjeguese nr. 3 dhe 6. Në këtë raport kjo gjetje është trajtuar tek çështja A1. Opinioni ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna e Rahovecit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

**Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të**

Kryetari i Komunës së Rahovecit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket Komunës së Rahovecit, prokurimi mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me ministritë, fusha e mallrave dhe shërbimeve, arkëtimi i llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurive.

## 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final[2] | 2019 Realizimi | % e Realizimit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e Fondeve:** | **13,760,891** | **15,155,251** | **14,688,602** | **97** | **13,064,949** | **11,661,181** |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 12,423,508 | 13,423,508 | 13,192,922 | 98 | 11,995,391 | 10,591,533 |
| Të bartura nga viti paraprak3 – | | 402,564 | 376,714 | 94 | 153,712 | 205,751 |
| Të hyrat vetjake4 | 1,168,768 | 1,168,768 | 961,842 | 82 | 778,167 | 769,469 |
| Donacionet e brendshme | - | 1,259 | 652 | 52 | 4,853 | - |
| Donacionet e jashtme | - | 64,375 | 64,280 | 100 | 95,493 | 89,100 |
| Financimi nga Huamarrja | 168,615 | 94,776 | 92,191 | 97 | 37,333 | 5,328 |

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
[3] Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.
[4] Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetiake.

Buxheti final në raport me atë fillestar ishte rritur për 1,394,360€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, donacioneve dhe rritjes së grantit qeveritar për 1,000,000€ me vendim të qeverisë. Ndërsa kishte zvogëlim të financimit nga huamarrja për 73,839€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 14,688,602€, me një përmirësim prej 5.5% krahasuar me vitin 2018.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2019 Realizimi | % e Realizimit 2019 | 2018 Realizimi | 2017 Realizimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:** | **13,760,891** | **15,155,251** | **14,688,602** | **97** | **13,064,949** | **11,661,181** |
| Pagat dhe Mëditjet | 7,537,669 | 7,559,595 | 7,330,406 | 97 | 7,219,001 | 6,991,962 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 1,514,330 | 1,421,464 | 1,352,072 | 95 | 975,106 | 694,080 |
| Shërbimet komunale | 255,500 | 255,500 | 246,469 | 96 | 248,823 | 249,753 |
| Subvencionet dhe Transferet | 250,001 | 1,250,001 | 1,216,728 | 97 | 179,062 | 188,900 |
| Investimet Kapitale | 4,203,391 | 4,668,690 | 4,542,926 | 97 | 4,442,957 | 3,536,486 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për Investime Kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 465,299€, si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak dhe donacioneve. Realizimi i buxhetit për investime kapitale kishte një performancë më të lartë këtë vit, ku përfshihen pagesat për vitin aktual, pagesat për obligimet e papaguara nga vitet paraprake, pagesat e ekzekutuara nga thesari dhe me vendim të gjykatës.

Rritja e buxhetit për Subvencione dhe Transfere për 1,000,000€ ishte bërë me vendim të qeverisë nr. 03/100 të datës 26.04.2019, për "Sanimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet".

Financimi nga huamarrja ishte reduktuar për 73,839€. Kjo shumë nuk ishte alokuar nga Ministria e Financave për skemën e pagesës së performances për projektin Shëndetësia Kosovare.

**Çështja A1 – Keq klasifikimi i shpenzimeve**

**Gjetja** Bazuar në Udhëzuesin Administrativ NR. 19/2009 për planin kontabël për përdorim nga Organizatat Buxhetore – Kodi ekonomik nënkupton natyrën e shpenzimeve dhe të hyrave në regjistrin e buxhetit.

Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna ka paguar 120,000€ për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale[5]. Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të komunës për të buxhetuar të gjitha shumat e nevojshme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Poashtu, pagesat e kryera nga Thesari, në vlerë 105,373€, në bazë të vendimeve të gjykatës/përmbarimore, ishin regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Nga investimet kapitale dhe nga mallrat e shërbimet ishin paguar 72,010€[6] për paga jubilare dhe përcjellëse, dhe nga mallrat e shërbimet ishin paguar 33,363€[7]. për investime kapitale. Pagesat nga kodet jo adekuate janë bërë kryesisht në mungesë të mjeteve në kategoritë adekuate.

**Ndikimi** Keqklasifikimi i shpenzimeve, pavarësisht rrethanave në të cilat ka ndodhur, shkakton mbivlerësim të një kategorie të shpenzimeve dhe nënvlerësim të kategorisë tjetër ekonomike. Përveq kësaj, pagesat me vendim të gjykatës kanë dëmtuar buxhetin e komunës për për shkak të shpenzimeve shtesë për procedurat përmbarimore në vlerë prej 14,406€. Kjo poashtu mund të ndikoj në pamje jo të drejt të shpenzimeve të paraqitura në PFV.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike adekuate, po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore.

### 2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Rahovecit në 2019 ishin në vlerë 1,103,403€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Krahasuar me vitin paraprak, niveli i realizimit të të hyrave ishte më i lartë për 11%. Përveç të hyrave direkte komuna realizon shpenzime edhe nga të hyrat indirekte si: gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut.

[5] Projekti "Shërbime për realizimin e vitalizmit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit - shtretërit shtëpiak"
[6] Nga Investimet Kapitale janë paguar 32,908€, Nga Mallrat dhe Shërbimet janë paguar 39,103€.
[7] Për projektin "Rregullimi i lumit në fshatin Zoqishtë"

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2019 Pranimet | % e Realizimit 2019 | 2018 Pranimet | 2017 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Të hyrat vetjake** | **1,168,768** | **1,168,768** | **1,103,403** | **94** | **994,864** | **820,959** |
| Të hyrat tatimore | 389,300 | 389,300 | 459,286 | 118 | 419,434 | 302,606 |
| Të hyrat jo tatimore | 681,468 | 681,468 | 644,117 | 95 | 575,430 | 518,353 |

**Çështja C1 Numër i madh i ankesave të bazuara nga qytetarët**

**Gjetja** Sipas "Ligjit nr. 06/L-005 neni 12, paragrafi 2, çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Sipas këtij paragrafi ndër përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim: regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, bashkëpunon me Ministrinë e Financave për vlerësimin e pronave të paluajtshme; shqyrton dhe vendos mbi ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Ne kemi evidentuar se edhe përkundër përpjekjeve komuna nuk kishte arritur të ketë një bashkëpunim të duhur sa përket azhurnimit të informatave në bazën e të dhënave të Tatimit në Pronë dhe vlerësimit të pronave. Rrjedhimisht në komunë kanë mbërritur 221 ankesa në lidhje me vlerësimin jo të duhur të pronave (142 për prona rezidenciale, 72 për prona komerciale dhe 7 për prona industriale). Nga gjithsej 221 ankesa, vetëm 9 janë refuzuar kurse pjesa tjetër e ankesave janë pranuar si të bazuara. Kjo tregon për nivelin e lartë të gabimeve në bazën e të dhënave.

Kjo ka ndodhur për shkak të vështirësive në implementimin e Ligjit të ri nr. 06.L/005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nga komunikimi i pa mjaftueshëm ndërmjet komunës dhe Ministrisë së Financave dhe për shkak të stafit të pa mjaftueshëm.

**Ndikimi** Mos azhurnimin i informatave dhe vlerësimi jo i duhur i pronave në bazën e të dhënave të tatimit në pronë mund të ndikoj në vështirësi në inkasimin e të hyrave nga tatimi ne pronë dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme si pasojë e paknaqësisë dhe ankesave të qytetarëve.

**Rekomandimi C1** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë intensifikuar aktivitetet e përbashkëta të Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave.

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 7,559,595€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,186 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,161. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 6 punëtor të rinj. Kemi testuar 44 mostra për teste substanciale në vlerë 281,856€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë. Gjetjet nga testimet janë paraqitur në vazhdim.

**Çështja B1 – Mangësi në menaxhimin e personelit**

**Gjetja** Për 19 zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri, komuna nuk ishte në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara apo kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të të cilave kryhet kompensimi i pagave. Vlera e kompensimit për këta zyrtar gjatë vitit 2019 ishte 113,871€. Sipas menaxherit të personelit nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bartjes së buxhetit tek Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, pjesë e të cilës janë këta punëtor sipas legjislacionit aktual në fuqi[8].

**Ndikimi** Pagesa e pagave për zyrtarët, në mungesë të dokumentacionit relevant, rezulton në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e përformancës, po ashtu pagesat e shtesave.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet.

[8] Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, si dhe aprovimit të Udhëzimit Adminitrativ Nr 21_2012, për transferimin e shërbimeve të zjarrfikjes nga komunat në MPB, procesi i bartjes së kompetencave është zhvilluar përmes memorandumeve që AME i ka nënshkruar me komunat, dhe me ketë rast të gjitha kompetencat për menaxhim, përfshirë procedurat e rekrutimit të stafit dhe kompensimin e pagave kanë kaluar tek AME. Mirëpo buxheti për zjarrëfiksit akoma nuk është bartur tek AME-ja përkundër një vendimi të Kryeminsitrit (të vitit 2013), dhe shumë kërkesave drejtuar MF-së dhe Kuvendit.

### 2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 1,676,964€, prej tyre ishin shpenzuar 1,598,542€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me, furnizim për zyre, furnizim të pajisjeve, pagesa me vendim të gjykatës, mirëmbajtje, shpenzime të udhëtimit, shpenzime komunale, shërbime kontraktuese etj. Kemi testuar 34 mostra për teste substanciale në vlerë 302,986€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

**Çështja C2 – Vonesa në pagesën e faturave**

**Gjetja** Sipas nenit 37, paragrafi 1 të Rreg. 01/2013 MF- Shpenzimi i parave publike, - Të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve.

Katër pagesa (të cilat përfshijnë katër fatura të vitit 2018 me vlerë 29,299€ dhe tetë fatura të vitit 2019 me vlerë 21,750€) kanë rezultuar me vonesa në pagesë. Vonesat varirojnë nga 13 ditë deri në dhjetë muaj. Kjo ka ndodhur për shkak të alokimeve me vonesë në fillim të vitit 2019, po ashtu pagesat e paplanifikuara të ekzekutuara me vendim gjykate paraqesin vështirësi financiare për pagesat e rregullta.

**Ndikimi** Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë që komuna të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të sigurojë se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren e MF. Përparësi duhet tu ipet obligimeve të bartura nga viti paraprak dhe atyre që kanë afat më të gjatë të pritjes.

**Çështja C3 - Pagesa e shpenzimeve para marrjes së shërbimit dhe mos dokumentim i tyre**

**Gjetja** Bazuar në kontratën e nënshkruar me 06.12.2019 për trajnimin e mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë informative në mësimdhënie, paragrafi 2 saktësohet që afati për realizimin e shërbimeve fillon dhjetor 2019 dhe vazhdon deri në fund të muajit dhjetor 2019, ose cilësdo periudhë tjetër të akorduar me shkrim mes palëve. Ndërsa kushtet e pagesës, të realizohen jo më vonë se 30 ditë pasi që Konsulenti t'ia dorëzojë faturat në dublikatë koordinatorit.

Fatura numër 58/2019 e datës 13.12.2019 në vlerë prej 3,375€ është paguar me 18.12.2019 në emër të trajnimit të mësimdhënësve, derisa këto shërbime janë ofruar gjatë muajit shkurt 2020. Përveç kësaj, trajnimi i mësimdhënësve nuk është ofruar sipas kontratës, pasi ishte paraparë që pesë module të zhvillohen nga dy ditë, ndërsa gjatë trajnimit një modul është zhvilluar brenda një dite. Përveq kësaj fatura për aneksin C (nën totali) në vlerë 1,725€ është paguar për 300€ më shumë, dhe nuk janë ofruar dëshmi, për shpenzimet e prezantuara në faturën kryesore të aneksit C, përveç faturës së ushqimit dhe kjo nuk ishte e plotë sepse nuk përputhej numri i pjesëmarrësve që ishin evidentuar në trajnim me numrin e atyre që janë shërbyer.

Këto kanë ndodhur nga mungesa e kontrolleve të brendshme dhe nga monitorimi i dobët i kontratës nga ana e Departamentit Komunal të Arsimit, koordinatorit të kontratës dhe zyrtarit çertifikues.

**Ndikimi** Pagesa e shpenzimeve para marrjes së shërbimit, rritë rrezikun për mos marrjen e shërbimeve të kontraktuara ose marrjen e shërbimeve jo cilësore. Pagesat pa dëshmi adekuate rrisin rrezikun që të ndodhin pagesa të parregulllta dhe të dëmtohet buxheti i komunës.

**Rekomandimi C3** Kryetari duhet të sigurojë që pagesat të kryhen vetëm pas sigurimit se janë pranuar shërbimet e kontraktuara dhe konfirmimit se ato janë në pajtim me kushtet e kontraktuara. Secila pagesë e shërbimeve të tilla duhet të mbështetet me dokumentacion komplet, duke përfshi faturat dhe dëshmitë e pjesëmarrjes.

**Çështja C4 – Mungesë e dëshmive relevante për ofrimin e shërbimeve**

**Gjetja** Sipas kontratës ''Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit-shtretërit shtëpiak'' në vlerë totale 194,398€, OE duhet të ofroj shtatë lloje të shërbimeve në kohëzgjatje për një vit.

Raporti i punës për ketë kontratë, për muajin shtator 2019 pasqyron se janë ofruar shërbime shëndetësore nga Caritas Kosova në cilësinë e OE dhe është lëshuar fatura Nr. 234/2019 në vlerë prej 15,000€ e cila ishte paguar me 16.10.2019 por vetëm pjesërisht (10,000€), shkaku i mungesës së buxhetit. Ne kemi testuar dy nga shtatë llojet e shërbimeve të faturuara dhe kemi gjetur se:

- numri i shërbimeve të faturuara, lloji i tretë i shërbimeve[9] sipas kontratës, në muajin shtator 2019 nuk korrespondojnë me evidencat e shërbimeve të pranuara nga pacientët;

- numri i shërbimeve të faturuara, lloji i gjashtë[10] i shërbimeve sipas kontratës, po ashtu për muajin shtator 2019, nuk ka fare dëshmi se kush ishin përfituesit e këtyre shërbimeve;

Më tej, shërbimet e faturuara sipas faturës 498/2019 në vlerë prej 15,000€ dhe të paguara me 05.12.2019 që pasqyrojnë shërbime të ofruara gjatë muajit nëntor 2019 janë identike për nga numri, me shërbimet e faturuara për muajin dhjetor 2019 sipas faturës 522/2019 në vlerë prej 15,000€ por e cila është paguar pjesërisht (5,000€) me 23.12.2019 për shkak të mungesës së buxhetit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së monitorimit të kontratës nga ana e menaxherit të kontratës, dhe për faktin se komisioni për pranimin e shërbimeve nuk e ka ushtruar funksionin e tij në plotni, pasi ka nënshkruar faturën e lëshuar nga kontraktuesi dhe raportin[11] pa u siguruar se shërbimet janë ofruar në pajtim me kontratën.

**Ndikimi** Pagesa e për shërbime që nuk janë marrë/pranuar, tregon për keq menaxhim të parasë publike.

**Rekomandimi C4** Kryetari duhet të inicojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar. Për rastet e lartëpërmendura ku nuk ka dëshmi të besueshme se janë ofruar shërbimet dhe është kryer pagesa, duhet të konsiderohet mundësia e kthimit të mjeteve në buxhetin e komunës. Personat përgjegjës për menaxhimi e kësaj kontrate duhet të mbahen përgjegjës për punën e tyre.

**Çështja C5 – Mangësi në procesin e prokurimit**

**Gjetja** Nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e prokurimit kërkohet që t'i respektojnë dhe të veprojnë në përputhje të plotë me kërkesat procedurale dhe materiale të Ligjit të Prokurimit Publik Nr 04/L-042 me plotësime dhe ndryshime.

[9] Shërbime infermierore ambulatore te pacientet, sipas përshkrimit në seksionin III (përshkrimi i shërbimit), brenda periudhës së kontraktuar, dhënje injekcioni, vendosje infuzioni, vendosje kateteri, pastrim plage, trajtim dekubiti, etj.(32,300 shërbime të këtij lloji planifikuar të ofrohen brenda vitit).

[10] Shërbimet sociale do të përfshijnë: Përmirësim i kushteve jetësore në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm, duke ndihmuar në mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit të brendshëm të shtëpisë tek personat e moshuar të vetmuar pa përkujdes familjare. Mundësi për të ruajtur dhe zhvilluar marrëdhëniet shoqërore përmes kontaktit me ta.(800 shërbime të këtij lloji planifikuar të ofrohen brenda vitit).

[11] Fjala raport është vendosur në thonjëza sepse ky raport është një përshkrim koti i cili nuk tregon saktë se cilat shërbime janë kryer dhe kur.

Te kontrata ''Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit Shtretërit shtëpiak'' në vlerë prej 194,398€, kemi gjetur se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit të lartëcekur, pasi që: fillimisht kontrata është klasifikuar si ''kontratë me vlerë të mesme'' e jo ''kontratë me vlerë të madhe'' siç parashihet nga neni 19, paragrafi 1 i LPP-së. Kjo është pasuar me afatet për pranimin e tenderëve prej 20 ditë në vend të 40 siç e përcakton neni 44, paragrafi 2.1 i të njëjtit ligj. Më tutje ''Njoftimi për dhënie të kontratës'' ishte bërë pas pesë ditëve (e jo brenda dy ditëve nga dhënia e kontratës, siç kërkohet me nenin 41 të Ligjit për Prokurimin Publik). Përveq kësaj të gjitha pagesat për ketë kontratë janë paguar nga Investimet Kapitale, derisa do të duhej të paguhen nga mallrat dhe shërbimet.

Këto parregullësi kanë ndodhur si pasojë e mospërfilljes së rregullave të përcaktuara dhe normave të ligjit, nga ana e akterëve të përfshirë në zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

**Ndikimi** Lëshimet e përmendura në procesin e prokurimit përbëjnë shkelje të Ligjit, derisa trajtimi i kontratës që i përket mallrave dhe shërbimeve, si investim kapital, rezulton në pasqyrë jo të saktë të shpenzimeve dhe pasurive në fund të vitit.

**Rekomandimi C5** Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e planifikuara sipas planit vjetor të prokurimit si furnizime, të trajtohen të tilla edhe gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dhe pagesave, për të siguruar klasifikim/pasqyrim të saktë të shpenzimeve. Poashtu, duhet të respektohen të gjitha dispozitat e LPP-së në lidhje me procedurat e prokurimit.

**Çështja C6 – Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës**

**Gjetja** Sipas Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik neni 61.7 kërkohet që pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani i menaxhimit të kontratës duhet të përgatitet dhe nënshkruhet nga Menaxheri i projektit dhe Operatori Ekonomik, dhe brenda dy ditëve të punës, duhet të përcjellet një kopje tek departamenti i prokurimit. Kjo vlen për të gjitha kontratat me vlerë të madhe dhe të mesme.

Për kontratën: ''Sigurimi i automjeteve të Komunës së Rahovecit'' të nënshkruar me datë 04.10.2019 dhe në vlerë 11,228€ dhe me kohëzgjatje prej 12 muajve, nuk ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës. Kjo pasi që nuk ishte caktuar menaxheri i kontratës sipas kërkesave të LPP. Në vend të kësaj, Kryetari i Komunës përmes autorizimit që mban datën 12.01.2018, ka autorizuar shefin e autoparkut, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, për regjistrimin e të gjitha automjeteve motorike zyrtare që janë në pronësi të komunës. Sipas diskutimeve me zyrtarët e Komunës, Kryetari i komunës e ka si praktikë që përmes një vendimi, autorizon çdo drejtor të departamenti dhe udhëheqës të njësisë që të jenë menaxher të projekteve për projektet që bien në atë departament. Kjo ka ndodhur shkaku i mungesës së njohurive të mjaftueshme të kërkesave ligjore lidhur me menaxhimin e kontratës.

**Ndikimi** Mos përgatitja e Planeve për Menaxhimin e Kontratës para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtim të palëve të kontratës, mund të ndikojë që automjetet të mos sigurohen me kohë dhe menaxheri i kontratës nuk do ta ketë në kontroll të plotë situatën, lidhur me shërbimet e porositura/pranuara dhe pagesat e realizuara.

**Rekomandimi C6** Kryetari duhet të siguroj që për çdo kontratë me vlerë të mesme dhe të madhe të emërohen menaxherët e kontratave, në pajtim me kërkesat e LPP-së, dhe menaxherëve të kontratave duhet tu bëhen të qarta kërkesat ligjore në lidhje me menaxhimin e kontratave. Rrjedhimisht ata duhet të përgatisin, monitorojnë dhe raportojnë në lidhje me planin për menaxhim të kontratës, konform kërkesave.

### 2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,250,001€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 1,216,728€. Ato kanë të bëjnë me Subvencionet për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për Kulturë Rini dhe Sport, Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Kemi testuar 24 mostra për teste substanciale në vlerë 116,476€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,668,690€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 4,542,926€. Ato kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve lokale, ndërtim të objekteve shëndetësore dhe arsimore, investim me marrëveshje mirëkuptimi, mirëmbajtje investive, transfer kapital – entitete jopublike, pajisje tjera etj. Kemi testuar 91 mostra për teste substanciale në vlerë 2,682,076€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

**Çështja B2 – Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare**

**Gjetja**

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, neni 12 limitet në zotime dhe shpenzime, pika 6 Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2019 dhe për dy (2) vitet në vijim.

Komuna e Rahovecit në bazë të Memorandumeve të Mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës ka nënshkruar kontrata për projekte infrastrukturore, mirëpo vlerat e kontratave të nënshkruara tejkalojnë shumat e parapara me ligjin e buxhetit dhe me memorandume:

- Për projektin "Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxe" me ligjin e buxhetit për vitin 2019 dhe dy vitet pasuese janë paraparë 3,400,000€, ndërsa janë nënshkruar 3 kontrata për LOT 1,2 dhe 3 në vlerë prej 6,513,954€, diferenca prej 3,113,954€ është e pambuluar me mjete financiare me ligjin e buxhetit;
- Për projektin "Asfaltimi i rrugës Fortesë-Hamoc-Rahovec"janë paraparë 700,000€, kurse kontrata është nënshkruar në vlerë prej 997,993€, diferenca prej 297,933€ është e pambuluar me ligjin e buxhetit; dhe
- Për projektin "Ndërtimi i rrugës Xërxe – Sapniq – Ratkoc" janë paraparë 800,000€, ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë prej 898,888€, diferenca prej 98,888€ është e pambuluar me ligjin e buxhetit.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

**Ndikimi**

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, dhe nënshkrim i kontratave përtej limiteve buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës duke qenë se duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ridestinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve. Kjo pamundëson realizimin e projekteve tjera të parapara të realizohen nga mjetet e ridestinuara.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

**Çështja A2 – Realizimi i aktiviteteve jashtë planit të prokurimit dhe mos njoftim i AQP-së në lidhje me to**

**Gjetja** Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik (me ndryshime dhe plotësime) AK duhet të bëj planin e prokurimt, në të cilin identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që AK parasheh ti prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa sipas nenit 9, pika 6, e ligjit të njëjtë precizohet që nëse aktiviteti i prokurimit nuk është përfshirë në planifikimin final të prokurimit, duhet të njoftohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) të paktën 5 ditë para autorizimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Komuna e Rahovecit, në planifikimin final të prokurimit kishte përfshirë gjithsej 57 aktivitete të prokurimit për furnizime, punë dhe shërbime, të cilat janë prokuruar gjatë vitit fiskal 2019. Mirëpo raporti i kontratave të realizuara dëshmon se në vitin 2019 janë realizuar edhe 30 aktivitete të cilat nuk ishin përfshirë në planin final të prokurimit. Kjo tregon se në planin e prokurimit nuk janë përfshirë të gjitha nevojat për furnizime, punë dhe shërbime. Për më tepër, për aktivitetet e zhvilluara jashtë planit, nuk është dërguar në AQP një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërisë e Fondeve para inicimit të aktivitetit përkatës të prokurimit.

Mos përfirja e të gjitha kërkesave/nevojave të njësive, në planin e prokurimit ka ndodhur për shkak të mungesës së komunikimit dhe bashkëpunimit me njësitë tjera të cilat bëjnë kërkesat për prokurim.

**Ndikimi** Planifikimi jo i plotë i aktiviteteve prokurimit, dhe realizimi i prokurimeve jashtë planit e vështirësojnë realizimin e planit të prokurimit dhe monitorimin e performancës si dhe krijon vështirësi financiare për komunën.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 128,001,655€, pasurive jokapitale 445,530€, si dhe e stoqeve 41,381€. Kemi testuar 91 mostra për teste substanciale në vlerë 2,682,281€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

---

**Çështja A3 – Mos shpalosja e pasurisë "Ndërtesa e Palestrës Sportive" e financuar nga MKRS**

**Gjetja** Sipas Nenit 11 të Rregullores MF – NR. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë në Organizatat Buxhetore, pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Sipas Memorandumit të Bashkëpunimit i lidhur në mes MKRS-së dhe komunës së Rahovecit ndërtimi i Palestrës Sportive ''Mizahir Isma'' është financuar plotësisht nga MKRS-ja. Për këtë projekt kishte përfunduar procesi i pranimit teknik me ç'rast ishte përgatitur raporti përfundimtar teknik nga organi mbikëqyrës me nr. të protokollit 861/2019 të datës 25.06.2019. Derisa në regjistrin e pasurive figuron e regjistruar vetëm parcela ku është ndërtuar Palestra, si "Tokë jo pjellore" me nr. 40789 në klasën e pasurive 32100. Objekti i Palestrës Sportive "Mizahir Isma" është aktualisht në përdorim dhe i plotëson të gjitha kriteret për tu konsideruar si pasuri e komunës. Rrjedhimisht kjo pasuri do të duhej regjistrohej në regjistra dhe të kalkulohet zhvlerësimi. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së dokumentacionit financiar dhe informatave lidhur me pagesat (vlerën) e objektit në fjalë.

**Ndikimi** Mos përfshirja e e pasurive me vlerë domethënëse në regjistra të pasurive, ndikon që cilësia e informarave në PVF të mos jetë e mirë dhe vlera e pasurive e shpalosur në PFV të mos jetë e saktë.

**Rekomandimi A3** Kryetari i Komunës duhet të kërkoj nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit të gjitha informacionet financiare në lidhje me objektin-palestrën Sportive dhe në bazë të këtyre informatave kjo pasuri duhet të përfshihet në regjistrat e e pasurive të Komunës.

**Çështja C7 – Mungesa e raportit të përgjithshëm për inventarizimin e pasurive dhe informatave në lidhje me pasuritë jashtë përdorimit**

**Gjetja**

Sipas Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB, përgjegjësitë e komisionit për inventarizim ndër të tjera është edhe hartimi i Raportit të Përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para-përgatitjes së PFV-ve. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara. Poashtu, sipas nenit 24 par 4 të Rregullores së njëjtë, gjatë raportimit Pasuria jo financiare jashtë përdorimit nuk do të prezantohet.

Komuna gjatë procesit të inventarizimit ka përpiluar raporte individuale të inventarizimit si: për pasuri nën 1,000€ jashtë përdorimit, për objekte, dhe për toka të regjistruara. Por Komuna ende nuk posedon Raportin e përgjithshëm për të gjitha pasuritë jo financiare mbi të cilat ushtron kontroll dhe ka përfitime ekonomike. Gjithashtu, komisioni kishte identifikuar 821 artikuj të pasurive të cilat i ka klasifikuar jashtë përdorimit. Edhe pse regjistri i pasurive është azhurnuar për shkak të këtij ndryshimi dhe është kryer rakordimi i regjistrave para dhe pas inventarizimit, në PFV nuk është bërë shpalosja lidhur me këtë ndryshim.

Kjo ka ndodhur për shkak të vëmendjes së pa mjaftueshme nga ana e Komunës për të poseduar një dokument i cili do të pasqyroj të gjitha informatat për vlerën dhe gjendjen fizike të pasurive si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra lidhur me pasuritë e përgjithshme.

**Ndikimi**

Mos realizimi i plotë i inventarizimit të pasurisë siç kërkohet me rregullore, ndikon që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund ti ekspozohen humbjes apo tjetërsimit. Kjo mund poashtu të rezultojë në mbivlerësimin e pasurive në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi C7**

Kryetari duhet të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.

## 2.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Rahovecit në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,159,689€. Kjo vlerë përbëhet nga Tatimi në pronë, taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe qiratë.

**Çështja C8 – Nivel i lartë i llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë**

**Gjetja** Komuna e Rahovecit për vitin 2019 ka raportuar llogari të arkëtueshme të tatimit në prona-objekte në vlerë 1,231,456€ dhe tatimin në tokë prej 56,377€. Një pjesë e madhe e borxheve të grumbulluara të tatimit në pronë (shuma prej 267,915€) i përkasin ish ndërmarrjeve shoqërore, të privatizuara gjatë procesit të privatizimit. Gjatë vitit 2019 nga LL/A e këtyre ndërmarrjeve janë arkëtuar 37,562€. Këto dhe llogaritë tjera të arkëtueshme janë bërë barrë për komunën, ato po rriten vit pas viti, dhe gjasat për arkëtim të detyrueshëm janë shumë të vogla.

Kjo është shkaktuar nga mungesa e iniciativës së përbashkët për zgjidhjen e çështjes së llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara në mes të Komunës dhe AKP-së të cilat përcjellën edhe me kalkulime të ngarkesave shtesë të gjobave dhe kamatave nga ana e komunës për tatimin në pronë mbi këto llogari.

**Ndikimi** Trendi i rritjes së vazhdueshme të LL/A ndikon në përkeqësimin e performancës së arkëtimit të LL/A të Komunës dhe nga ana tjetër trendi do të jetë negativ vit pas viti në të ardhmen.

**Rekomandimi C8** Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhjen e përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Poashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.

## 2.4 Detyrimet

### 2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 870,338€. Këto obligime kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe me Investime Kapitale që përfshinë vlerën më të lartë prej 765,427€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Krahasuar me vitin paraprak vërehet ulje e vlerës së obligimeve të papaguara për 39% ose 565,275€. Shkaku kryesor për bartjen e këtyre obligimeve është mungesa e mjeteve që ka ardhur si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit nga vitet paraprake.

### 2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019, ishte 1,238,923€. Pas klasifikimit të duhur të detyrimeve kontigjente nga ana e Komunës, vlera e detyrimeve kontigjente ka mbetur mbi një milion, pasi vlera prej 31,372,807€ ka qenë konteste civile të padive të cilat janë bërë nga komuniteti serbe pas vitit 2000 ku kanë pas dëme materiale, e që ky obligim nuk i përket komunës, pasi për sigurinë në Republikën e Kosovës është KFORI.

Me kërkesën e thesarit kjo vlerë është larguar nga tabela Detyrimet kontigjente në PFV - neni 18.

### 2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas të dhënave të Komunës vlera e detyrimeve kontraktuale për Komunën e Rahovecit në fund të vitit 2019 ishte 3,128,331€.

## 2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. NjAB kishte hartuar Planin Vjetor të vitit 2019 si dhe Planin Strategjik për vitet 2019-2021. Për vitin 2019 ishin planifikuar 10 auditime të rregullta dhe një auditim sipas kërkesës, prej tyre katër auditime me rrezikshmëri të lart dhe shtatë auditime me rrezikshmëri të mesme.

Për vitin 2019 kishte arritur që të përmbushë planin e auditimit si dhe të kryej edhe një auditim shtesë (ad hoc) sipas kërkesës së menaxhmentit. Prej auditimeve të kryera, 44% mbulojnë vitin 2019 ndërsa 56% mbulojnë vitin 2018, si në vijim:

Komuna ka të themeluar Komitetin e Auditimit (KA) prej 5 anëtarëve, gjate vitit janë mbajtur 3 takime për arsye të ristrukturimit të stafit në këtë komitet me vonesë.

---

**Çështja B3 – Funksionim jo efektiv i NjAB-së**

Në kuadër të auditimit tonë ne kemi vlerësuar edhe efikasitetin e NjAB-së në funksion të përmirësimit të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm. Në ketë drejtim NjAB nuk ishte mjaftueshëm efektive, përkundër faktit se i ka kryer të gjitha auditimet e planifikuara. Kjo për faktin se më shumë se gjysma e auditimeve të kryera kishin fushëveprim vitin 2018. Poashtu, sipas NjAB-së nga gjithsej 57 rekomandimet e dhëna në vitin 2019 vetëm 30 ishin zbatuar derisa rekomandimet tjera ishin në proces. Mirëpo kjo është e vështirë për tu konfirmuar duke pasur parasysh se 10 nga 12 auditimet e kryera në vitin 2019, mungonte plani i veprimit të menaxhmentit, për zbatimin e rekomandimeve nga raportet e AB (kjo është në kundërshtim me procedurat standarde të operimit, të aprovuara nga MF). Edhe cilësia e auditimeve ka vend për përmirësim pasiqë disa nga rekomandimet nuk janë shumë të qarta.

Këto kanë ndodhur nga mungesa e vëmëndjes së duhur, nga neglizhenca e stafit të departamenteve ku janë kryer auditimet, ndërsa KA nuk kishte dhënë ndonjë kontribut për përmirësimin e efektivitetit të punës së NjAB-së.

**Ndikimi** Fokusimi i auditimeve në aktivitetet e viteve paraprake i pamundëson NjAB-së që të jetë në gjendje të japë këshilla në lidhje me procest aktuale dhe parandalimin e ndodhjes së lëshimeve dhe parregullsive eventuale. Mungesa e planeve për zbatimin e rekomandimeve e bën të pamundur vlerësimin e zbatimit të tyre dhe rrjedhimisht evitimit të dobësive të evidentuara nga NjAB. Rekomandimet e paqarta shkaktojnë huti tek stafi dhe nuk i kontribojnë përmirësimit të menaxhimit apo kontrolleve të brendshme.

**Rekomandimi B3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual në departamentet ku vlerësohet që reziku është më i lartë, të kërkojë që cilësia e auditimit të përmirësohet dhe nga departamentet të kërkohet që rekomandimet e auditimit të trajtohen në pajtim me procedurat stadarde të operimit të aprovuara nga Ministri i Financave.

# 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të Komunës së Rahovecit ka rezultuar në 21 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Sipas zyrtarëve të komunës 15 rekomandime janë zbatuar, 4 janë zbatuar pjesërisht dhe dy të tjera do të zbatohen në vitin 2020. Megjithatë gjendja sipas auditimit duket ndryshe nga këto konstatime.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 5 rekomandime janë zbatuar, 2 të mbyllura, 11 ishin në proces të zbatimit, dhe 3 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

## Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2018 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes** | Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në klasifikimin e drejt të shpenzimeve dhe për të eliminuar dobësitë në prezantimin e drejt të llogarive të arkëtushmeve dhe obligimeve, të shpalosura në theksimin e çështjes te opinioni i auditimit.<br>Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të | Llogaritë e Arkëtueshme dhe Obligimet e papaguara janë prezantuar drejt në PFV, derisa klasifikimi jo i drejt i shpenzimeve ishte evident edhe këtë vit. | Rekomandim i mbyllur (rekomandimet që ndërlidhen me theksimin e çështjes janë dhënë në fushat përkatëse). |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. | | |
| 2 | **Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** | Kryetari duhet të sigurojë që përformanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe i adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Planifikimi buxhetit duhet ti referohet mundësimeve reale për sigurimin e fondeve nga të hyrat dhe realizimit me prioriteti të buxhetit për fshirjen e obligimeve të prapambetura. | Buxheti për IK është shpenzuar 97%, dhe për mallra e shërbime 95%. | Rekomandim i zbatuar |
| 3 | **Të hyrat** | Kryetari duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren duke angazhuar anketues kompetent. | Gabimet ne llogaritjen e koeficientëve janë eliminuar, megjithatë janë identifikuar mangësi shkaku i vlerësimit të pronave me ligjin e ri. | Rekomandim në proces të zbatimit (shih çështjen C1) |
| **4** | | Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme departamentet përgjegjëse të arkëtoj të gjitha të hyrat e prapambetura. Në të kundërtën të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike apo ushtrimin e veprimtarisë, për mos kryerjen e obligimeve ndaj komunës. | Janë marrë masa në aplikimin e mekanizmave të reja, janë bërë vërejtje me shkrim dhe për borgjlinjët me vlerë më të madhe janë dërguar lëndët tek përmbaruesi, megjithatë ende nuk vërehen rezultate pozitive sa i përket arkëtimit të të hyrave të prapambetura. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen C8) |
| **5** | **Pagat dhe mëditjet** | Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Pagesat e shtesave bëhen vetëm për zyrtarët që parashihen me vendimin e Qeverisë dhe shumat e përfituara në kundërshtim me këtë vendimi ti kthehen buxhetit të | Dosjet e personelit për zyrtarët e emergjencës dhe sigurisë gjenden nën administrimin e Agjencisë së Pavarur për Emergjencë në MPB, komuna realizon vetëm pagat e tyre. | Rekomandim i pazbatuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | komunës. | | |
| 6 | | Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe menaxheri i personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Po ashtu drejtoret e shkollave të monitorojë pushimet e stafit dhe vlerësimet e përformcës dhe dëshmitë e njëjta të vendosen në dosje të personelit. | Dëshmitë për përvojën e punës janë kompletuar, megjithatë ka mungesë të dëshmive tjera të nevojshme për dosje | Rekomandim pjesërisht i zbatuar (Rekomandim i është vendosur në letërmenaxhm ent). |
| 7 | **Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale** | Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në marrëveshje për shërbime të veçanta/kontrata për pune specifike bëhet në përputhje të plot me kornizën ligjore dhe koha e angazhimet në këto raste nuk tejkalon afatet e përcaktuar me ligje. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë se angazhimet e tilla bëhen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. | Nuk kemi identifikuar parregullsi në angazhimin e MSHV-ve. | Rekomandim i zbatuar |
| 8 | | Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike. | Për vitin 2019 përzgjedhja e projektit me Caritas Kosova është kryer me procedurë të hapur të prokurimit, ku janë përcaktuar kriteret dhe përgjegjësit me kontratë, megjithatë janë identifikuar mangësi në implementimin e projektit | Rekomandim pjesërisht i zbatuar (shih çështjen C4 dhe C5) |
| 9 | **Investimet kapitale** | Kryetari duhet të sigurojë që personat përgjegjës kontrollojnë dokumentacionin e nevojshëm para ekzekutimit të pagesave si dhe të forcoj masat e kontrollit që punët apo mallrat pranohen nëpërmes dëshmive përkatëse apo raporteve të pranimit. | Kryetari ka marrë vendim që Menaxherët e kontratave dhe kompania mbikëqyrëse e kontraktuar nga komuna të bëjnë menaxhimin, dorëzimin dhe konstatimin e punëve të kryera në investime kapitale për të gjithë OE. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen C6) |
| **10** | | Kryetari të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që realizimi i projekteve përmbushët | | Rekomandim i mbyllur |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontratën përkatëse dhe ekzekutimi i të gjitha pagesave të bëhet në pajtim me kontratën dhe të garantohen me sigurim të ekzekutimit duke eliminuar edhe mundësin e kontraktimit pa fonde të mjaftueshme. | | |
| **11** | | Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat, duhet të sigurohet që fillimisht të mos lejoj inicimin e asnjë procedure të prokurimit në mungesë të një projekti ekzekutiv si dhe duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve ku gabimet e tilla të mos përsëriten. | Janë marrë masa, për projektet e realizuara janë hartuar projektet ekzekutive para inicimit të procedurave të prokurimit, me përjashtim për projektet e financuara nga një organizate tjetër. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen A8) |
| **12** | | Kryetari të siguroj që zyra e prokurimit të ketë kontrolle të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve. | Kontrata janë nënshkruar pas zotimit të mjeteve, megjithatë buxheti i planifikuar me buxhet dhe KASH nuk e mbulon çmimin e kontratës. | Rekomandim i pazbatuar |
| **13** | | Kryetari, përmes Menaxherit të prokurimit duhet të sigurojë se çdo procedurë e prokurimit të analizohet dhe vlerësohet me kujdes nga ana e komisionit vlerësues, në mënyrë të evitohen gabimet e mundshme gjatë procesit të prokurimit gjithashtu të sigurohen që po respektohen kriteret e përcaktuara ligjore. | Nuk kemi identifikuar rastet te tilla ne auditimin e vitit 2019. | Rekomandim i zbatuar |
| **14** | | Kryetari duhet të sigurojë që hartimi i projekteve ekzekutive të realizohet në pajtim me kërkesat ligjore dhe zyra e prokurimit para inicimit të procedurave të prokurimit për ekzekutimin e punëve të posedoje projektet e kompletuara. | Janë marr masa, me përjashtim të Marrëveshjeve të mirëkuptimit që janë nënshkruar pa vlerësim të saktë të nevojave dhe pa projekt ekzekutiv. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen B2) |
| **15** | **Çështjet e përbashkët a për mallrat dhe shërbimet** | Kryetari i Komunës duhet të forcoj kontrollet për tu siguruar se disponojnë fonde të nevojshme për përmbushjen e obligimeve | Ekzistojnë pagesa me vendim të gjykatës, megjithëse komuna ka ndërmarr hapa për të | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen B1) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **si dhe investimet kapitale** | financiare me kohë. Më tej të siguroj se komuna trajton të gjitha obligimet ligjore ndaj pretendentëve legjitim dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim të eliminimit të shpenzimeve të panevojshme shtesë. | eliminuar shpenzimet e panevojshme shtesë. Një nga veprimet për ketë ka të bëj me evidentimin e punëtorëve të pensionuar të arsimit dhe shëndetësisë, përllogaritja e pagave jubilare dhe përcjellëse dhe kërkesa e parashtruar tek MF për të siguruar fonde për kompensimin e tyre. | |
| 16 | **Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale** | Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. | Janë marr masa, komuna ka formuar komisionin për inventarizim, mirëpo komisioni nuk ka kryer punën sipas vendimit te kryetarit. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen C7) |
| 17 | | Kryetari duhet të siguroj se do të hartohet një politik e brendshme e cila definon qartë kërkesat dhe përgjegjësitë për përdorimin e veturave. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se gjatë përdorimit të automjeteve zyrtare azhurnohen fletudhëtimet dhe veturat përdoren vetëm sipas aprovimeve të personave përkatës. | Përdorimi i automjeteve aplikohet vetëm pas aprovimit të formularëve nga personat përkatës. | Rekomandim i zbatuar |
| 18 | **Të Arkëtuesh met** | Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale. | Janë marr masa në aplikimin e mekanizmave të reja, janë bërë vërejtje me shkrim dhe për klientët me vlerë më të madhe janë dërguar lëndët tek përmbaruesi, megjithatë ende nuk vërehen rezultate pozitive sa i përket mbledhjes së | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen C8) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | LL/A. | |
| 19 | **Obligimet e papaguara** | Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme, që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre. | Raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj, megjithatë ekzistojnë ende obligime që tejkalojnë afatin ligjor për pagesë. | Rekomandim në proces të zbatimit (Shih çështjen C2) |
| 20 | **Sistemi i auditimit të brendshëm** | Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari i Komunës duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të bashkëpunoj me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. Si dhe të sigurojë se një rishikim i kontrollit të cilësisë do të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB. | Nuk ka dëshmi për përcjelljen e zbatimit te rekomandimeve. | Rekomandim i pa zbatuar |
| 21 | **Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut** | Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. | Raportet financiare janë të kompletuara. | Rekomandim i zbatuar |

| Nr. | Fusha e auditimit | Rekomandimet e vitit 2019 |
|---|---|---|
| 1 | Realizimi i Buxhetit | Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë të gjitha veprimet në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet me përpikëri sipas kodeve ekonomike |

| | | |
|---|---|---|
| | | adekuate, po ashtu të gjitha obligimet të paguhen me kohë në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesave shtesë për procedura gjyqësore. |
| 2 | Te hyrat | Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë intensifikuar aktivitetet e përbashkëta të Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. |
| 3 | Paga dhe Mëditje | Kryetari duhet të kërkoj nga personat përgjegjës, që për zyrtarët të cilët paguhen nga buxheti i komunës të sigurohen së paku dosjet me informata bazike përfshirë kontratat e punës, si dhe raportet mujore për vijueshmërinë e tyre në punë, për tu siguruar se janë paguar vetëm punëtorët legjitim dhe që kanë ofruar shërbimet. |
| 4 | Mallra dhe Shërbime | Kryetari duhet të sigurojë se ekzekutimi i pagesave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren e MF. Përparësi duhet tu ipet obligimeve të bartura nga viti paraprak dhe atyre që kanë afat më të gjatë të pritjes. |
| 5 | | Kryetari duhet të sigurojë që pagesat të kryhen vetëm pas sigurimit se janë pranuar shërbimet e kontraktuara dhe konfirmimit se ato janë në pajtim me kushtet e kontraktuara. Secila pagesë e shërbimeve të tilla duhet të mbështetet me dokumentacion komplet, duke përfshi faturat dhe dëshmitë e pjesëmarrjes. |
| 6 | | Kryetari duhet të inicojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Për secilin muaj duhet të hartohen raporte detale për secilin shërbim të ofruar dhe pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria se shërbimet janë pranuar. Për rastet e lartëpërmendura ku nuk ka dëshmi të besueshme se janë ofruar shërbimet dhe është kryer pagesa, duhet të konsiderohet mundësia e kthimit të mjeteve në buxhetin e komunës. Personat përgjegjës për menaxhimi e kësaj kontrate duhet të mbahen përgjegjës për punën e tyre. |
| 7 | | Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e planifikuara sipas planit vjetor të prokurimit si furnizime, të trajtohen të tilla edhe gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit dhe pagesave, për të siguruar klasifikim/pasqyrim të saktë të shpenzimeve. Poashtu, duhet të respektohen të gjitha dispozitat e LPP-së në lidhje me procedurat e prokurimit. |
| 8 | | Kryetari duhet të siguroj që për çdo kontratë me vlerë të mesme dhe të madhe të emërohen menaxherët e kontratave, në pajtim me kërkesat e LPP-së, dhe menaxherëve të kontratave duhet tu bëhen të qarta kërkesat ligjore në lidhje me menaxhimin e kontratave. Rrjedhimisht ata duhet të përgatisin, monitorojnë dhe raportojnë në lidhje me planin për menaxhim të kontratës, konform kërkesave. |
| 9 | Investimet Kapitale | Kryetari duhet të siguroj se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim. |
| 10 | | Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP |

| | | |
|---|---|---|
| | | konform kërkesave ligjore. |
| 11 | Pasuritë | Kryetari i Komunës duhet të kërkoj nga Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit të gjitha informacionet financiare në lidhje me objektin-palestrën Sportive dhe në bazë të këtyre informatave kjo pasuri duhet të përfshihet në regjistrat e e pasurive të Komunës. |
| 12 | | Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare të bëj regjistrimet dhe vlerësimin e të gjitha pasurive në posedim të komunës, dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Diferencat e shfaqura duhet të sqarohen dhe regjistrat duhet të azhurnohen sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. |
| 13 | Llogaritë e Arkëtueshm e | Kryetari duhet të ndërmerr veprime adekuate për një zgjidhjen e përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Poashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave. |
| 14 | NjAB | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani vjetor i auditimit të fokusohet më shumë në proceset e vitit aktual në departamentet ku vlerësohet që reziku është më i lartë, të kërkojë që cilësia e auditimit të përmirësohet dhe nga departamentet të kërkohet që rekomandimet e auditimit të trajtohen në pajtim me procedurat stadarde të operimit të aprovuara nga Ministri i Financave. |

# Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

**(e shkëputur nga ISSAI 200)**

*Forma e opinionit*

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

*Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit*

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

*Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit*

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

# Shtojca II: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATË PRANIMI/DORËZIMI: 02.07.2020

| Njësia Org. | Shif.klasif. | Nr. Prot. | Nr.i faqeve |
|---|---|---|---|
| 04 | 47 | 937 | 1 |

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO**

**KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE ORAHOVAC/ MUNICIPAL ASSEMBLY RAHOVEC**

Zyra e Kryetarit/Ured Predsednika/ Office of Mayor

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

**z.Smajl Latifi**.........................................

Kryetar i Komunës së Rahovecit

Data:02.07. 2020, Rahovec,

**01 Nr. 08/20**
**Rahovec, 19.08.2020**

